

“Jo secili prej nesh mund të bëjnë gjëra të mëdha, por të gjithë mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe” Nënë Tereza



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 131, shtator 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

FALEMINDERIT PAPA FRANÇESKU

21 shtatori i këtij vitit ishte për Shqipërinë dhe për gjithë shqiptarët kudo janë një ngjarje shumë e rëndësishme. Kjo ditë kishte një shkëlqim të veçantë mirësie dhe bekimi për të gjithë. Kjo, sepse ngjarje të tilla ndodhin rallë. Në këtë ditë shkeli në tokën Arbënore Papa Françesku, që me mirësinë, çiltërsinë, ëmbëlsinë dhe thellësinë e mesazheve, këshilloi rrugë e mënyra për një jetë më të mirë, për marrëdhënie shoqërore, ndërkomunitare, ndërfetare si një mundësi e domosdoshme për përparimin e shoqërisë e njerëzimit.



FALEMINDERIT PAPA FRANÇESKU

21 shtatori i këtij vitit ishte për Shqipërinë, për kombin shqiptar dhe për gjithë shqiptarët kudo janë një eveniment shumë i rëndësishëm. Kjo ditë kishte një shkëlqim të veçantë, një rrezatim mirësie dhe bekimi për të gjithë. Kjo erdhi nga një ndodhi që ndodhë radhë. Në këtë ditë zbriti në tokën Arbënore Papa Françesku, që me mirësinë, çiltërsinë, ëmbëlsinë dhe thellësinë e mendimeve të tij, këshilloj rrugë e mënyra për një jetë më të mirë, për marrëdhënie shoqërore, ndërkomunitare, ndërfetare si një mundësi e domosdoshme për përparimin e shoqërisë, për përparimin e njerëzimit.

Emocionet e të gjithë të pranishmëve në pritjen e Papës janë të papërshkrueshme. Shikoje njerëz që u rridhnin lot, që thërrisnin “Rroftë Papa”, por edhe i drejtoheshin në kor thjeshtë “Fran-çes-ku” të ndarë në rrokje, tundeshin shami me simbolet e vizitës së Papës, flamurë të Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, fëmijë që zgjatnin duart që ti takonin me Papën, secili mendohej që të fiksonte në mënyrën e tij, me aparatën e tij Papën teksa përshëndeste me ëmbëlsi, shtrinte dorën sikur do ti takonte të gjithë pjesëmarrësit, u buzëqeshte të gjithëve.

Shëtitëria Dëshmorët e Kombit ishte zbuluar edhe me fotot e 40 martirëve të kishës Kato- like, por edhe të tjerë, që dhanë jetën me emrin e Jezu Krishtit në gojë, nga kthetrat e gjakosura të diktaturës totalitare, e që pritët të lumturohen për veprën e tyre. Midis tyre janë edhe shumë nga komuniteti dukagjinaz që sot e gjithë ditën na bëjnë nderë, i bëjnë nderë Dukagjinit dhe gjithë Shqipërisë, na ndriçojnë mendjen dhe shpirtin, na japin forcë e guxim për të përballuar vështirësitë, na ushqejnë për të falur, për të rritur dashurinë midis njerëzve, sepse secili nga

këta martirë, në fjalët e fundit të jetës së tyre, i falnin ekzekutorët e tyre. Kjo është e madhe, është shumë e fuqishme, kjo është dhe duhet të jenë dritë, shpresë dhe përparim, në errësirën e hakmarrjes dhe gjakmarrjes.

Vizita e Papa Françeskut ishte një dritë e jashtëzakonshme, fatbardhësi, gëzim dhe shpresë për të ardhmen. Të gjithë duhet ta kemi në mendje dhe zemër porosinë e Papa Françeskut për “shqipen”, e cila fluturon shumë lart e shumë larg, por vendlindjen dhe prejardhjen e vet nuk e harron. Ajo kthehet në folenë e

saj.

Në këtë ditë shtatori, qielli i Shqipërisë u hap, që nga atje lartë Krishti të hell vështrimin, mirësinë e dashurinë mbi ne popullin shqiptarë, mbi njerëzimin në tokë, të gjitha këto nëpërmes zërit, dorës, shpirtit, syrit, buzëqeshjes dhe ëmbëlsisë së Papa Françeskut.

Vizita dhe bekimi i jashtëzakonshëm që Papa Françesku i dha popullit dhe kombit shqiptarë, në këto kohë të veçanta për vendin, por edhe në ndërkombtarisht, ka çliruar energji pozitive për ne, por edhe shumë më gjerë. Kjo është ngjarje shumë

e madhe, dhe pas ngjarjeve të mëdha si kjo e 21 shtatorit që u zhvillua në Shqipëri, ka dhe duhet të kenë reflektime natyrore njerëzore, reflektime dhe shpresa për të ardhmen.

Faleminderit Papa Françesku, për mirësinë që rrezatove, për porositë që na drejtove, për horizontet që hape, për tërë mësimet që shpërndave në shërbim të së ardhmes së njerëzimit.

Faleminderit, faleminderit!

Luigj Shyti, 22. 9. 2014



PERJETESOHET NE NJE SHTATORE DOKTORI I DUKAGJINIT

Dy vjet pas ndarjes nga jeta në një kompleks aktivitetesh vlerësohet dhe nderohet doktori i Dukagjinit, Prel Gjeloshi, që nga ky shtator pranë Qendrës Shëndetësore Grude e Re do të ngrihet dhe të qëndroje përjetësisht busti i tij. Këshilli i Komunë Rrethina, i ka dhënë dr. Prel Gjeloshit titullin “Qytetar Nderi I Komunës Rrethina” pas vdekjes. Gjithashtu këshilli i komunës ka vendosur që Qendra Shëndetësore e kësaj komune në fshatin Grudë e Re të marrë emrin “Qendra Shëndetësore Dr. Prel Gjeloshi, Rrethina”.

Ajo që na bëri përshtypje dhe që ja vlen për t’u theksuar është pjesëmarrja masive e banorëve të kësaj komune, miqve, kolegëve dhe të afërmve të dr. Prel Gjeloshit në këtë ceremoni. Ishin të pranishëm përfaqësues të Këshillit të Qarkut Shkodër, të Drejtorisë rajonale të shëndetit publik, përfaqësues të komunave të Dukagjinit dhe të mediave lokale.

Në fjalën e tij, kryetari i komunës Rrethina z. Luan Harusha, ne mes te tjerave theksoj: “Ndjejmë dhimbje dhe respekt tek vlerësojmë dhe përkujtojmë punën e palodhur të dr. Prel Gjeloshit për shumë vite në shërbim të banorëve të kësaj komune, vendosja e këtij busti, por edhe vlershmet e tjera te bëra më pare janë një detyrim moral për te nderuar njerëz të tillë qe lanë pas një emër dhe shembull te shkëlqyer për brezat”.

Ne një aktivitet te organizuar ne ambientet e bar Restorant “ANTIKA” . e morën fjalën përfaqësues te shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, te komunave te Dukagjinit, mjeke dhe shumë të ftuar,

Një aktivitet i organizuar dhe i ideuar nga ana ime në formën e një takimi përkujtimor, ku moderatorja e tij gazetarja Lindita Martini përball një publiku të shumtë i ftoj një nga një ne foltoren e improvizuar shume diskutonte.

Ne një material historik të përgatitur ne formën e një eseje z Ndue Sanaj pasqyroj rrjedhat historike te Pultit, dhe e renditi dr Prel Gjeloshin nder figurat e rëndësishme të kësaj zone që la gjurme dhe një emër të mire për brezat.

Përsëhendeti pastaj kryeplaku i fshatit Kir z Ndre Cubi, i cili e cilësoi dr Prelën si një nder figurat që pasqyron cilësitë më te mira te vlerave njerëzore që ky fshat ka trashëguar ndër breza .

Folën me shumë respekt për jetën dhe pune e dr Prel Gjeloshit edhe sekretari i Shoqatës “Atdhetare- Dukagjini” z Luigj Shyti, Prek Doci nga komuna Shale, dr aktual i QSH Grude e Re miq e bashkëfshatar....

Dr. Prelë Gjeloshi ishte njëri ndër kuadrot më të përgatitur dhe të devotshëm Dukagjinit e më gjerë. Emri i tij i bën nder kurdoherë të gjithë kësaj komune, ku do të ruhet kurdoherë i gjallë e i paharruar portreti i tij si mjek dhe si njeri i jashtëzakonshëm.

Dr. Praela do të mbetet gjithnjë i dashur e i respektuar edhe për të gjithë, nga të gjithë flitej me shumë respekt për vlerat profesionale dhe qytetare që doktori ka pasqyruar me punën e tij. Jeta dhe vepra e dr. Prel Gjeloshit u ka bërë një nder bluzave të bardha dhe profesionit të shenjtë

të mjekut. Ai ishte modeli i korrektësisë, i përkushtimit dhe i sakrificës në punën e tij.

Tek flisnin njëri pas tjetrit kolegë dhe miq të tij, shihje sesi pasqyrohej dhimbja dhe respekti në fytyrat e qindra të pranishmëve që ndodheshin atë ditë pranë qendrës shëndetësore Grudë e Re. Aty shihje se bashkoheshin në një dhimbja dhe krenaria, respekti dhe vlershmi, dhimbje për humbjen e parakohshme të një presoni që ka lënë gjurmë të pashlyera në kujtesën e të gjitha atyre që patën rastin te jenë pacientët e tij. Krenari e heshtur, por e merituar e bashkëfshatare të tij të fshatit Kir, e të banoreve të Dukagjinit, të cilët do të ndihen gjithmonë krenar për djalin e tyre. Për pjesëtarët e familjes, për djemtë Klodin dhe Benardin, bashkëshorten e tij, vëllezërit dhe motrat kjo ditë do të mbetet e paharruar, sepse e panë edhe një herë se me dhimbjen e tyre bashkohet një komunitet shumë i gjere. Foli për të pranishmit edhe djali i madh i dr. Prelës, kirurgu i ardhshëm Klodiani. I falënderoj të gjithë, i emocionoj të gjithë, dhe ju premtoj se do të përpiqet të eci ne gjurmët e profesionalizmit dhe përkushtimit te të atit në profesionin e nderuar të mjekut.

Dr. Prelë Gjeloshi: Prelë Gjeloshi lindi në fshatin Kir të Dukagjinit, me 19 tetor të vitit 1955. Aty kaloi fëmijërinë dhe mbaroi me rezultatet shumë të mira shkollën fillore e 8 vjeçare. Arsimin e mesëm e lidhi me ëndrrën dhe dëshirën e tij të madhe, që një ditë të vishte bluzën e bardhë të mjekut, prandaj vazhdoi Shkollën Mjekësore në qytetin e Shkodrës, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Zgjodhi plot pasion Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Tiranës. Studenti i shkëlqyer Prelë Gjeloshi. Shumë i njerëzishëm, fjalëpakë, i dashur e korrekt në shoqëri, i gatshëm për të ndihmuar këdo, studiuues serioz e me kërkesa të pazakonshme për të marrë vlerësime maksimale në çdo lëndë, dashamirës e i thjeshtë me të gjithë, këto ishin disa nga tiparet që ishin skalitur më së miri në personalitetin e tij. Pas mbarimit të Fakultetit të Mjekësisë, në degën Mjekësi e përgjithshme gjatë viteve 1979-1984,

Dr. Praela fillon punë në vendlindjen e tij. Tashmë auditoret e universitetit ishin zëvendësuar me praktikën e përditshme mjekësore përballë njerëzve të sëmurë. Njohuritë e shumta shkencore, që nga shkolla e mesme e deri në vitin e fundit të fakultetit, nuk e zhgënjyen asnjëherë mjekun e ri. Aftësitë e tij i kapërcenin disa herë nivelet e të tjerëve që xhironin kor-

ridoret e spitaleve të mëdha të qyteteve, por Dr. Praela, për disa vite, vazhdoi të shërbente qetësisht e me të gjithë përkushtimin e duhur në vendin e tij, midis bashkëfshatarëve të vet, që i donte dhe i respektonte. Përpjekjet e shumta për të zhvilluar më tej njohuritë e tij në një fushë të veçantë të mjekësisë, nuk u ndalen asnjëherë. Fatkeqësisht, auto-



ritet shtetërore nuk i morën asnjëherë seriozisht faktin se ai ishte një student qe kishte mbaruar shkëlqyeshëm dhe ishin tepër të rrallë në rrethin e Shkodrës ata që kishin mbaruar për mjekësi me një mesatare të tillë.

E megjithëkëtë, Dr. Praela vazhdonte të studionte e të punonte pa ndërprerje. Më në fund, pas viteve 1990, vjen familjarisht në qytetin e Shkodrës dhe vazhdon të punojë si mjek i përgjithshëm, veçse përsëri larg, në periferi të saj. Për Dr. Prelën nuk kishte rëndësi vendi ku do të ushtronte detyrën e nderuar të mjekut. Pacientët e tij do ta ndienin gjithnjë pranë, natën e ditën, në dimër e në verë, në ambulancë e në shtëpi, dhe kurdoherë me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë e të përkushtimit të pashoq, i gatshëm për të bërë të pamundurën në shërbim të ruajtjes së shëndetit të tyre. Sipas vështirësive praktike që shtroheshin përpara tij, komunikonte me shumë korrektësi e profesionalizëm me specialistët e ndryshëm në Shkodër e Tiranë, u jepte atyre men-

dime të sakta dhe zbatonte me kujdes rekomandimet që merrte prej konsultave të ndryshme.

Pacientët shkonin te Dr. Praela pa druajtje, me sigurinë se do t’i priste kurdoherë mirë, me besimin e plotë se nuk do të kursente asgjë për ta, prandaj mori vazhdimisht mirënjohjen dhe respektin e tyre. Fatkeqësisht, atëherë kur Dr. Praela ishte në kulmin e aftësive të tij profesionale, fillon ta gërryey nga brenda, tinëzisht e pa pushim, një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme. Ja që edhe mjekët janë si të gjithë të tjerët përballë kërcënimeve të jetës nga patologjitë e ndryshme. U bë gjithçka që mund të bëhej për të, brenda dhe jashtë Shqipërisë, por ishte e pamundur të shpëtohej jeta e këtij njeriu që do të mund të shpëtonte kush e di se sa jetë të tjera. Kështu u ndërpre në mënyrë të papritur dhe tepër parakohe udhëtimi i gjatë i Dr. Prelë Gjeloshit, por ai la pas një trashëgimi të madhe, një emër të mirë e të respektuar mes njerëzve. Bashkë me gruan e tij ai rriti dhe edukoi dy djem të mirë që vazhdojnë studimet e larta në Itali, gjithashtu për mjekësi, Klodin e Benardin, të cilët tani ndihen tepër te ngarkuar me përgjegjësi morale dhe profesionale, por që me siguri do jenë gjithnjë krenarë për babin e tyre. Unë kam pasur rastin ti njoh nga afër këta dy djem, këto dy vlera të çmuara të shoqërisë që me shumë gjasa, do ti venë njohuritë e tyre ne shërbim te njerëzve, por në një shtet tjetër dhe me vjen vërtet keq qe elita intelektuale është e detyruar apo e prire

të emigroje.

Kane kaluar vetëm dy vite dhe vlershmet respekti e mirënjohja për punën e tij të palodhur nuk kanë munguar. Dr Prel Gjeloshi është nderuar nga Komuna Pult me titullin “Krenaria e Komunës Pult”, nga Shoqata “Atdhetare-Dukagjini”, me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës”. Pastaj edhe vlershmi dhe nderimi që i është bërë nga Komuna Rrethina Shkodër, që kulmuan sot me vendosjen e këtij monumenti.

Dr. Prelë Gjeloshi bën pjesë me dinjitet në ajkën e elitës intelektuale të Dukagjinit e më gjerë. Emri i tij i bën nder kurdoherë të gjithë kësaj krahine, në historinë e mjekësisë, së të cilës do të ruhet kurdoherë i gjallë e i paharruar portreti i tij si mjek dhe si njeri i jashtëzakonshëm.

Dr. Praela do të mbetet gjithnjë i dashur e i respektuar edhe për të gjithë ne, shokët dhe kolegët e tij, që e njohën.

Përgatite nga **LULASH BRIGJA**



Vatikani dhe Shqiptaret

Senati demokristian, nën drejtimin e Presidentit të këtij Senati, shkrimtarit Lazer Sani, me datën 20 shtator 2014, me rastin e vizites së Papa Françeskut në Tiranë, organizoj Konferencën Shkencore, me teme: “Vatikani dhe Shqiptaret”

PRESEDIUMI I KONAFERENCES

Ne këtë konferencë morën pjesë personalitete të Kulturës e të artit në Tiranë dhe qytete të tjera të vendit. Nga Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” morën pjesë Ndue

Sanaj, Luigji e Gjyste Shyti, Lazer Kodra, Zef Bari, prof. as dr. Zef Gjeta, inxh Gjon Fierza, Fran Molla e të tjerë.

Konferenca i zhvilloi punimet në Akademinë e Shkencave, në sallën “Aleks Buda”. Në këtë konferencë u ligjëruan këto kumtesa:

1. Marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut me Selinë e Shenjtë, Prof. As. Dr. Gjon Berisha
2. Koalicioni antiosman i Papa Kalistit

- të III dhe Skënderbeu, Dr. Dorian Koçi,
3. Propaganda Fide dhe Arbëria, Dr. Kastriot Marku
4. Nënë Tereza dhe shqiptarët, Visar Zhiti, poet,
5. Selia e Shenjtë - pararojë e kombit shqiptar, Ndue Ukaj, poet e studiues,
6. Kodet kulturore në veprën e At Zef Pëllumbit, Dr. Agron Gjekmarkaj, studiues
7. Ecuria e mendësisë fetare të shqiptarët nga Rilindja deri sot, Prof. As. Dr.

Thanas Gjika,

8. Kontributi i Vatikanit në arsimin shqiptar, Dr. Nikollë Loka, historian,

9. Kisha katolike në diktaturë, Dr. Azem Qazimi, studiues

Në fund të konferencës, në shkallët e godinës, me pjesëmarrësit u bë një foto e përbashkët.

Redaksia e gazetës

FAMILJE QË NUK DUHET LËNË NË HARRESË

Ku do e kurdohet ka pas familje me emër, dhe që kanë mbete në histori, për të cilat flitet në dhomat e burrave, në kuvende e të tjera. Rëndësia qëndron se familjet me emër të mire, kanë lënë trashëgimi në breza, e cila nuk është e lehtë. Përgjegjësia më e madhe bije në brezat pas ardhës. Kërkohej që jo vetëm të kujtohet, por edhe të respektohet i pari i tyre. Kjo arrihet duke i ruajtur traditën dhe duke ia përshtatë ato kohës. Me vdekjen e një burri të mençur e me reputacion në ngushëllime e sipër, njerëzit thonë: Ky vdiq u prehtë në paqe. Pastaj shtojnë se, ka lënë shumë mirë prapa. Pra, të bardhë ditën! E kundërta ndodh me ata burra të mire, të cilët kur nderojnë jetë, krahas ngushëllimeve thonë: Vdiq një burrë i mire e gjynah që nuk ka lënë trashëgimtar që vlejë. Këto dy anë të medaljes ndodhin vazhdimisht.

Në këtë shkrim po ndalem tek një burrë e një familje e njohur në Shalë, në zonën e Dukagjinit e më gjerë. Ky është Lulash Mala nga fshati Lekaj i Shalës. Lindi në vitin 1883 dhe vdiq në vitin 1953. Jeta e tij 70 vjeçare ishte e mbushur me vuajtje e histori. Në moshë fare të vogël mbeti jetim, pa nënë e pa babë. Kalojë një fëmijëri të vështirë, por vështirësitë nuk e penguan atë me u edukua me ndjen-

jën e dashurisë për vendin. Kur mbushi moshën 20 vjeç, atë e mobilizojnë për të shkuar ushtar në Jemen. I betuar për të mos i shërbyer kurrë turkut, planifikon arratisjen dhe kështu veprojë. Pasi i veshën me uniformë të ushtrisë turke e



po bëheshin gati për të udhëtuar drejtë Jemenit, gjënë momentin e i shkëputet karvanit dhe arratiset për në Mal të Zi. Udhëtimi ishte shumë i vështirë, mesi i muajit dhjetor. Rruga nga do të kalonte ishte e mbushur me bore, duhej kaluar bjeshkën e Maja-Pejës e bora i kalonte

të 2m. Falë fizikut të tij e guximit ja arrin qëllimit e pas 18 orësh arrin në Beranje. Themi fizikut të tij, se edhe sot i thonë vendit, ku ka kapë Lulash Mala ujkun për këmbë, duke shpëtuar bagëtinë. Forcat turke arrin Lekaj, duke kërkuar në çdo

vend, për ta arrestuar. Kur nuk e gjetën. Bënë reprezalje në familje, plaçkiten të gjithë pasurinë e pastaj i dogjën shtëpinë. Megjithatë ai kërkohej nga regjimi turk, ai kthehet ilegal në Lekaj. Duke rrezikuar jetën, e cila nuk i dhimbesh për vendin e tij. Vazhdimisht regjimi dërgonte forca

të shumta për të mposhtur Dukagjinin. Familja e Lulash Malës ishte nderë 35 familjet e Shalës që nuk pranuan me dorëzua armët dhe dolën kaçak me gra e fëmijë. Pasi qëndruan disa kohë kaçak, u detyruan të arratisen në Mal të Zi me gjithë familje. Në krye të karvanit ishte Lulash Mala, i cili i njihte mire rrugët. Ky ishte nderë kryesorët që ju përgjigj thirrjes së Mehmet Shpendit për të thyer burgun e Shkodrës. Nxorën të burgosurit politikë, të cilët kishin fole kundër regjimit.

Pas shumë vitesh kthehet në Lekaj. Martohet me një vajzë nga Bregu-Lumit, në një shtëpi me emër. Grua burrneshë dhe familjare e shkëlqyer. Lulashi duke mos duruar asnjë pa drejtësi, nuk u pajtua me regjimin e zogut. Prandaj ishte edhe një nderë udhëheqësit e Lëvizjes së Dukagjinit. Përsëri detyrohet të arratiset aty ku tani e kishte bërë si shtëpi të dytë. Xhandarmëria e Zogut erdhi në Dukagjin e krahas shumë shtëpive, dogji edhe shtëpinë e Lulash Malës. Pas kthimit nga arratia, rregulluan shtëpinë e djegur dy here. Fillojë jetën nga e para. Çiftit u lindën 12 fëmijë, 8 prej tyre u rritën të edukuar. Fëmijët ishin 2 vajza dhe 6 djem.

(vijon në faqen 9)

Stani: Vatikani, kontribut të jashtëzakonshëm në mbijetesën e shqiptarëve

- BISEDË ME PRESIDENTIN E SENATIT DEMOKRISTIAN, SHKRIMTARIN, LAZËR STANI -

Si e vlerësoni vizitën e atit të shenjtë në Tiranë, thjeshtë një vizitë shpirtërore si i Pari i fesë katolike në Botë, apo ishte një vizitë edhe politike, që na shërben ne, për të ardhmen tonë evropiane?

Vizita e Atit të Shenjtë, Papa Françeskut në Tiranë, të dielën e 21 shtatorit, është një nga ngjarjet më të rëndësishme, që kanë ndodhur ndonjëherë në kryeqytetin shqiptar, një vizitë historike, që për një ditë e ktheu Tiranën në kryeqytet të botës. Rrallëherë qytetarët shqiptarë kanë përjetuar një emocion të tillë, një gëzim dhe lumturi të tillë që reflektohej në fytyrat e të gjithëve, veçanërisht të të rinjve. Dua të shtoj këtu se, edhe qytetarët shqiptarë dhe institucionet e tyre përfaqësuese, mundësuat një pritje madhështore, dinjitoze, çka na nderoi ne si komb. Vetë Ati i Shenjtë, përpara se të vizitonte Shqipërinë e pati shpjeguar arsyen e kësaj vizite: Ai tha se do të bënte një vizitë për të nderuar një popull që ka vuajtur shumë, që ka shumë martirë të besimit të krishterë, klerikë dhe besimtarë që kanë dhënë jetën për besimin e tyre, por edhe si një popull fisnik, që pavarësisht besimeve të ndryshme, jeton në paqe, ne harmoni, një popull që kurrë nuk ka pasur konflikte fetare. Pas vizitë së tij në Tiranë, Ati i shenjtë u shpreh se në Shqipëri myslimanët, ortodoksët dhe katolikët jetojnë në vëllazëri, duke e rritur edhe më tej vlerësimin për shqiptarët.

Në fjalën e mbajtur në presidencë, por edhe gjatë meshës së mbajtur në sheshin “Nënë Tereza”, Ati i Shenjtë jo vetëm e bekoi popullin shqiptar, tokën shqiptare, por edhe dha mesazhe të rëndësishme, për besimtarët katolikë, për besimtarët e të gjitha besimeve, për të rinjtë, për politikën dhe njerëzimin mbarë. Janë këto mesazhe që e bëjnë këtë vizitë sa madhështore aq edhe historike. Mendoj, që të gjithë shqiptarët, qofshin këta qytetarë të thjeshtë, apo kryeparë të këtij vendi, duhet t’i mbajnë mend mirë mesazhet e Atit të Shenjtë dhe t’i reflektojnë ato në jetën dhe veprimtarinë e tyre të përditshme.

Çfarë ju ka bërë më shumë përshtypje në mesazhet e Atit të Shenjtë?

Në udhëtimin e tij apostolik në Shqipëri, Ati i Shenjtë, Papa Francesku, dha disa mesazhe të rëndësishme, jo vetëm në kuptimin religjioz, por edhe në kuptimin shoqëror, qytetar e njerëzor, mesazhe që i drejtohen gjithë njerëzimit, botës së mbërthyer nga kriza ekonomike, kriza e besimit, bjerrja e vlerave, konfliktet dramatike, botës që vuan nga pabarazia dhe padrejtësitë. Por mesazhi më i rëndësishëm për

mua, është mesazhi që u drejtoi të rinjve shqiptarë, duke i inkurajuar besimin e tyre tek e ardhmja. E shkuara dramatike dhe zhgënjimet e vazhdueshme në këto njëzet e katër vite, nga politika, partitë, qeverisjet, lëkundën besimin e shumë njerëzve, jo vetëm tek një e ardhme më e mirë për Shqipërinë, por edhe te besime që janë thelbësore për njeriun, si besimi tek e mira, besimi tek drejtësia, besimi te humanizmi, tek të drejtat dhe liritë njerëzore, tek solidariteti dhe vlerat e jetës në përgjithësi. Një brez i tërë i ri, që endet i pashpresë rrugëve, i papunë, i arsimuar keq, i zhgënjyer, pa perspektivë për të ardhmen. Njeriu ka nevojë të besojë diku, që të jetojë me dinjitet, me dashuri, me shpresë. Po ku të besonin të rinjtë shqiptarë? Të shëmbëlltyra e politikanit mashtrues dhe të korruptuar, që nuk i shqipton, por i pështyn fjalët, tek drejtësia që pjell padrejtësi në çdo orë të ditës, tek intelektualët e përlulur para pushteteve, tek liria e nëpërkëmbur, tek pedagogët që iu shesin notat, tek ndershmëria që është shndërruar në një nocion bastard, tek puna dhe aftësitë e tua që nuk të mbajnë dot barkun me bukë? Me një ndricim hyjnor Ati i shenjtë u solli shpresë këtyre të rinjve të zhgënjyer, ju deklaroi se ju jeni evropianë, se ju jeni si shqiptarët që fluturojnë lart dhe larg, pa e harruar kurrë follenë e tyre. Unë pashë shpresë dhe lumturi në sytë e të rinjve që kishin dalë për të pritur dhe nderuar Atin e Shenjtë, kthim te besimit të vetja, tek Shqipëria, tek e ardhmja. Një përndritje dhe vegim hyjnor në sytë e tyre, që kam bindjen se do të ndikojë në jetët e secilit dhe të Shqipërisë. Ati Shenjtë me fjalët dhe bekimet e tij, solli paqe në shpirtat e tyre të trazuar, shpresë në zemrat e tyre të zhgënjyera.

Sigurisht, sipas mendimit tuaj, cili është kontributi i dukagjinasve në ruajtjen e krishterimit në vendin tonë?

Nëse flasim për kontributin e ruajtjes së besimit të krishterë të dukagjinasve, nga mesjeta e deri në kohët moderne, atëherë do të thosha se dukagjinasi janë një komunitet martir. Sakrifikuan gjithçka për të ruajtur besimin e tyre, sakrifikuan mirëqenien, jetët, u ngujuan mes maleve, por jetuan me dinjitet dhe krenari, duke ruajtur besimin e tyre të krishterë, duke mbajtur gjithmonë të gjallë shpresën tek Zoti dhe Jezusi. Në relacionet e tij për Vatikanin Frang Bardhi flet për dukagjinasi, si luftëtarë të lirisë dhe të krishterimit, duke u shprehur se një luftëtar dukagjinasi vlen sa dhjetëra luftëtarë të fushës. Ne të gjithë e dimë, sakrificat që bënë dukagjinasi në rezistencën antios-

mane, qoftë në epokën e ndritur të Gjergj Kastriotit, kur princi i Pultit, Pjetër Spani u rreshtua përkrah ushtrisë së tij me djemtë dhe luftëtarët e vet, por edhe më vonë, në vitet e gjata e të errëta të pushtimit të trojeve shqiptare, se vetë Dukagjini nuk u nënshtua kurrë. Përkundrazi, bëri vazhdimisht rezistencë, duke qenë vazhdimisht në luftë për aq vite sa zgjati pushtimi. Ju e dini se gjithë folklori i Dukagjinit ka si lajtmotiv luftën me turk dhe luftën me shkja, (Në luftë me turk e në luftë me shkja / tuj u pre e tuj u vra)



që është edhe memoria jonë historike dhe krenaria e dinjiteti ynë njëkohësisht. Përveç kontributit në mbrojtjen e besimit të krishterë, dukagjinasi kanë gjithashtu kontribut të paçmuar ende siç duhet në ruajtjen e vlerave tona kombëtare, të gjuhës së kulluar shqipe, të kulturës tonë. Prej këtij komuniteti që jetonte në ngushtësi midis maleve kanë dalë klerikë të shquar dhe personalitete të kulturës dhe artit me të cilët do të krenohet çdo komunitet apo qytet në botë: mjafton të përmend këtu dy poetët e mëdhenj shqiptarë, Martin Camaj dhe Frederik Rreshpja, themeluesin e prozës moderne shqipe Ernest Koliqi, aktorin e talentuar Ndrekë Luca, apo piktorin Lin Delia. Këta emra të ndritur që sot qëndrojnë në panteonin e kulturës shqiptare, jo vetëm e nderojnë komunitetin e Dukagjinit, por dëshmojnë edhe potencialin e racës, aftësinë për të kapur majat e qytetërimit dhe për ta paraprirë atë.

Kush u be shkë i nismës për organizimin e Konferencës me temë “Vatikani e shqiptaret” dhe çfarë qëllimi i kishit venë vetes?

Unë jam president i Senatit Demokratian, një institucion i krijuar nga intelektualë shqiptarë,

krijues të fushave të ndryshme, shkrimtarë, historianë, profesorë universitetesh, gazetarë të njohur me një program të qartë për të kontribuar në afirmimin e vlerave evropiane të shqiptarëve, por edhe në afirmimin e vlerave kristiane dhe evropiane të shqiptarëve. Në përbërjen e senatit, përveçse nga Shqipëria, kemi intelektualë të njohur nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe diaspora. Pra, është një institucion me shtrirje gjithëshqiptare. Programi ynë nuk është politik, por shkencor dhe kulturor, dhe

të temave që u referuan në këtë konferencë ato shumë shpejt do të botohen si libër në vete me titullin “Vatikani dhe shqiptarët”.

Në këtë konferencë ishte një temë shumë interesante për mua, ndoshta ndër më interesantet, e cila ishte “Ecuria e mendësisë fetare te shqiptarët nga Rilindja deri më sot”, e përgatitur nga prof. As. Dr Thanas Gjika. Ne fakt, cili ishte qëllimi i kësaj teme?

Profesor Gjika është autor i një libri për Shën Palin dhe Ilirët, një libër shumë i rëndësishëm që është botuar kohët e fundit në Tiranë dhe pjesëmarrja e tij në konferencë me një temë të trajtuar me profesionalizëm “mbi ecurinë e mendësisë fetare te shqiptarët nga Rilindja deri më sot”, ishte një nder për ne. Në këtë temë Profesor Gjika sjell fakte të panjohura ose pak të njohura për publikun për ecurinë e mendësisë fetare të shqiptarët në procesin e evropianizimit të tyre, kthimin e tyre në identitetin natyral, në përpjekjet për distancimin nga trashëgimia e dhunshme e Perandorisë Osmane. Një moment domethënës, është pagëzimi i Faik Konicës në të krishterë katolik, kur ishte student në Francë, me emrin Faik Dominik Konica. Konica, siç e dimë të gjithë, mbetet një nga mendjet me të ndritura dhe një nga intelektualët më të mëdhenj që ka nxjerrë ndonjëherë kombi shqiptar. Mendimtar, filozof, shkrimtar, publicist, politikan, diplomat, njeri me kulturë të jashtëzakonshme, një gjeni i llojit të vet të papërsëritshëm. Dhe ky njeri me pagëzimin e vet i ftoi shqiptarët të kthehen në rrënjët e tyre të hershme, në identitetin e tyre evropian. Pavarësisht nga mosrealizimet, ai kurrë nuk i pushoi përpjekjet për një Shqipëri evropiane, një Shqipëri zonjë midis kombeve të tjerë të qytetëruar. Përmenda rastin e Konicës, sepse tema e Profesorit është me e gjerë, sepse aty analizohen gjerësisht tendencat e shqiptareve në këtë periudhë të trazuar të historisë së tyre dhe evoluimin e mendësisë së tyre fetare, duke i afruar ata gjithnjë e më shumë me Evropën.

I nderuar Lazer, ju faleminderit për bisedën që bëmë, me të cilën bëmë përpjekje të paraqesim para lexuesit të gazetës “Dukagjini” disa përfundime të nevojshme të vizitës së Atit të Shenjtë, Papa Franceskut në Tiranë. Ju uroj faqe bardhe në misionin tuaj.

U falënderoj juve, që më dhatë mundësinë të komunikojë me lexuesit e gazetës sonë “Dukagjini”!

Bisedoi, **NDUE SANAJ**

RREFIMI I NJE KISHE MARTIRE

Dokumentar kushtuar persekutimit dhe qëndresës së besimit katolik në Shqipëri

Përgatiti **MAJKO MILA**

Dëshmia dhe vëllazërimi ishin fjalët kyçe të ditëve që lamë pas dhe si për të përforcuar edhe më shumë këto dy argument, Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shqipërisë, pas një pune disa mujore, me 19 shtator 2014 në kinema "Millennium"-Tiranë, arriti të shfaqte dokumentarin e titulluar "Rrëfimi i një Kisha Martire" i cili kishte në thelbin e tij dëshmitë e të mbi-jetuarve në kampet dhe burgjet e regjimit komunist, por mbi të gjitha kishte synimin të kujtonte dhe të dëshmonte për ata të cilët atij regjimi nuk arritën t'i mbi-jetonin, shumë prej të cilëve ishin edhe klerikë katolikë.

Komisioni Drejtësi dhe Paqe prej rreth 2 vitesh zbaton një projekt, i cili ka në thelbin e tij pikërisht periudhën komuniste dhe veçanërisht anën më të egër të saj, burgjet dhe kampet e përqëndrimit.

Shfaqja e këtij dokumentari vetëm 2 ditë para vizitës së Atit të Shënjtë, Papa Françeskut, në Shqipëri ishte një arsye më e fortë për ta paraqitur atë para publikut dhe për t'i kujtuar atij edhe një herë se çfarë ndodhi në ato vite të tmerrshme, kur me dhjetëra klerikë u torturuan, u

burgosën e u vranë për faktin e thjeshtë se, donin atdheun e tyre dhe predikonin për një të mirë sublime.

Megjithë mizorinë e një pushteti in-



porant, ata klerikë ditën t'i rezistonin ur-rejtjes, por më shumë frikës ndaj tyre si një rrezik i mundshëm, i cili mund të kërcënonte pushtetin e një individi "suprem".

Në dokumentar tregohen fakte dhe dëshmi të personave, të cilët kanë pasur mundësinë të takonin klerikë gjatë

qëndrimit të tyre në burgjet komuniste, tregojnë thjeshtësinë se si ata klerikë pranonin fatin e tyre duke pranuar çdo lloj fyerjeje apo torture, por pa humbur ide-

alet dhe besimin, të cilat jo pak herë ishin edhe arsye për ekzekutimin e tyre.

Ai pushtet nuk kënaqej vetëm me eliminimin fizik të klerikëve, ata kerkonin edhe eliminimin e çdo lloj ideali dhe ndjenje fetare në të gjithë popullsinë dhe këtë kerkonin ta arrini me shkatërrimin e kishave, por edhe të shumë objekteve të

besimeve të tjera fetare duke arritur kulmin në vitin 1967 kur u shkatërruan apo u transformuan në objekte për qëllime të tjera 2169 objekte fetare, prej të cilave 157 kisha katolike dhe kuvende.

Këto synime shihen qartë edhe në dokumentar ku nuk janë të pakta skenat e hedhjes në erë të kishave apo shndërrimin e tyre në objekte publike të cilat mund t'i shërbenin propagandës së një qeverie e cila zot kishte vetëm veten.

Gabimi më i madh i atij regjimi ishte se, nuk mund të shkatërronin apo transformonin atë çfarë ishte në zemrat dhe mendjen e njerëzve, duke i kthyer ato në favorin e tyre dhe kjo gjë është parë qartë edhe në këto ditë ku rrugët që dikur ishin të pushtuara nga parudha për atë të cilët mohuan gjithçka për asgjë, tani janë të pushtuara nga fytyrat, shpeshherë edhe të qeshura, të atyre të cilët asgjë nuk mohuan e megjithatë arritën të mundnin persekutorët e tyre jo me ur-rejtje, por me dashuri dhe falje dhe kjo mund të vihet re edhe në fjalët e fundit të shumë prej atyre që u vranë:

I FALI TË GJITHË ATA QË MË KAN BAKEQ! RROFTË KRISHTI! ROFTË SHIPNIA!

Martirë dukagjinas




ATË BERNARDIN PALAJ OFM



ATË ÇIPRIAN NIKAJ OFM




DOM DEDË PLANI



ATË GJON SHLLAKU OFM



DOM LAZER SHANTOJA



DOM MIKEL BELTOJA



GJELOSH LULASHI



QERIM SADIKU

MBESHTETJE E KOMUNITETIT DHE ZHVILLIM I QËNDRUESHEM I BIMEVE MJEKËSORE

KOMUNA SHOSH NË ZBATIM TË NJË PROJEKTIT

Pyjet, kullotat e bimët mjekësore që zhvillohen në juridiksionin e komunës Shosh paraqesin një rendësi jetike për banoret vendor të zonës. Janë pasuri me të cilat lidhet ngushtë përmirësimi i kushteve jetësore, duke i zhvilluar ato në mënyrë të qëndrueshme. Duke u ndale veçmas për bimët mjekësore mund të themi se si lloje me të rëndësishme vlerësohen: trumza, lisna, dëllinjën e kuqe, dëllinje e zeze, cërmëdelli. Disa bimë të tjera me përhapje më të kufizuara por me shumë vlere si; salepi, xhirokulli, boronica, gentiana, hithra, lule shtogu, lule bliri, etj. Ka pas një tradite, përsëri banoret vendor si një burim shtese të ardhurash, vazhdojnë të grumbullojnë bime mjekësore kryesisht trumzën, boronicën, lule bliri, lule shtogu, etj. Llogariten se gjatë sezonit të grumbullimit rreth 60% e familjeve merren me këtë veprimtari pa lenë pas dore dhe punët në bujqësi dhe blegtorinë. Duke vlerësuar potencialet prodhuese të bimëve në territorin e komunës rezultojnë se me pak se 40% e sasisë së mundshme grumbullohet dhe dërgohet në treg. Por ndërkohe në zona dhe teritore të veçanta ka dhe mbi shfrytëzim dhe dëmtim të bimëve mjekësore. Në periudhën 2008-2009, për pyjet dhe kullotat në pronësi të komunës Shosh është hartuar një plan menaxhimi. Aty ka një përshkrim të gjendjes ekzistuese të fondit pyjor, të kullotave dhe si dhe masat që parashikohen të zbatohen për 10 vjeçarin. Komuna OJF, buxheti i shëtit kërkohet të sigurojnë fonde për zbatim të atyre punimeve dhe arritje të objektivave të planifikuara,

Janë pikërisht faktet dhe argumentet kryesor sa më sipër që Instituti i Mjedisit dhe Zhvillimit Rural (IMZH) dhe komuna Shosh të mbështetur nga Koperacioni Austriak (ADA) si donator, tashmë kanë hartuar dhe po zbatojnë projektin: “Punësimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm rural të komunitetit në zonat e marginalizuara nëpërmjet grumbullimit, përpunimit të bimëve mjekësore dhe eterovajore në komunën Shosh në Qarkun e Shkodrës”. Projekti ka disa objektiva dhe nga zbatimi do arrihen disa rezultate që konsistojnë tek: i) Shtimi i kapaciteteve dhe krijimin e grupeve të interesit; ii) Rritja e njohurive; mbi teknikat e mbledhjes, trajtimit, magazinimit dhe ambalazhimit i produkteve; njohja me mjetet dhe teknologjitë e reja, që bimët medicinale dhe erëza të përmeshin standardet dhe kërkesat baze për treg; iii) Kryerja e një studimi me të plotë për llojet kryesore të bimëve në komune, përgatitja e një manuali praktik “Për njohjen, grumbullimin, përpunimin, ruajtjen dhe ambalazhimin e bimëve mjekësore”, ky do ju shërbejë grumbulluesve dhe përpunuesve të pare; vi) Përgatitja e një parcele demonstrimi model të disa kulturave të bimëve mjekësore në territorin e komunës; v) Përmirësimi i disa sipërfaqeve ekzistuese me bime mjekësore kryesisht të atyre afër qendrave të banuara, nëpërmjet kryerjes së disa punimeve të

thjeshta sipërfaqësore. vi) Ngritja e një pike grumbullimit në qendër të komunës, kjo për të lehtësuar transportin dhe produktet të trajtohen dhe përpunohen pas grumbullimit që të përmeshin kushtet e standardeve të kërkuara, pra të kemi një vlere produkti sa më të madhe për

uleve të trajnimit teknik, për rritjen e njohurive mbi përpunimin, trajtimin, magazinimin dhe ruajtjen të bimëve mjekësore. Përzgjedhja e sipërfaqes demonstrative është vlerësuar nga ekspertet dhe pushteti vendore si objektiv i rëndësishëm, po vazhdojnë takimet me palët e interesu-

primtarisë se saje ka bimët mjekësore me tërë kompleksitetin e tyre.

Puna e deritanishme dhe rezultatet e pritshme të këtij projekti, i fokusuar tek aspektet sociale dhe mjedisi kanë ndikime të drejtpërdrejta tek përmirësimi sadopak i jetesës dhe uljes së varfërisë në



grumbulluesit. Për t'u njohë më mirë me veprimtarinë e deritanishme dhe si ka funksionuar bashkëpunimi me pushtetin dhe komunitetin vendor, donatorin, u takuam me z. Artur Galanxhi, drejtuesin e zbatimit të projektit. Vlerësohet bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me kryetarin e komunës z. Mark Kulla, me grupet e interesit dhe një mbështetje totale e dhënë nga donatori (ADA). Nëpërmjet gazetës “Dukagjini”, dua ti falënderoj të gjithë, duke kërkuar të vazhdojmë së bashku në mbështetje të njeri tjetri deri në finalizim të projektit. Me tej z. Galanxhi shton: Deri tani nga ekspertet janë përgatitë e modulet dhe janë kryer trajnimet për ndërtimin e kapaciteteve dhe krijimit të grupeve të interesit/shoqatës së grumbulluesve dhe përpunuesve të bimëve mjekësore e eterovajore. Pas vizitave në terren, po punohet në përgatitjen e mod-

ara për vendin dhe llojet që do mund të kultivohen që tashmë se shpejt do ketë një përfundim. Ndër rezultatet e punës gjatë sezonit të verës ishte demonstrimi me grumbulluesit tradicional i teknikave të grumbullimit dhe vjeljes pa dëmtuar bimët. Njohja me rregulloren teknike gjatë punës në terren me disa grupe u ndoq me interes dhe rezultatet kanë qenë të mira. Është përcaktuar pika dhe po merren masa për përgatitjen e magazinës grumbullimit të bimëve sipas standardeve të nevojshme. Krahas veprimtarive në terren po punohet në përgatitjen e materialeve shkresore dhe zbatimin e procedurave për themelimin e shoqatës grumbulluesve të bimëve mjekësore si subjekt juridik i miratuar në gjykatë, që do ushtroje veprimtarinë në komunën Shosh. Është shoqata e pare që krijohet në nivel qarku, ku në thelb të ve-

zona të thella si Shoshi. Jo vetëm kaq, ky projekt mund të shërbejë si një model dhe për komunat e tjera të Dukagjinit. Edhe ato kanë potenciale të mëdha bimësh mjekësore për të cilat kërkohet përkujdesje e vazhdueshme. Projekte të tilla efektive sociale dhe mjedisore, duhet bere përpjekje të ketë sa më shumë në këto zona. Paradoksi i kohës që jetojmë: se komunat e Dukagjinit, janë të pasura në burime natyrore, por popullsia që jeton në gjirin e tyre është mjaft e varfër duhet të mos ekzistojë. Një ndër burimet për më shumë të ardhura duhet vlerësuar dhe konsideruar dhe bimët mjekësore natyrore.

Përgatiti nga Gjon Fierza
Agjencia Kombëtare e Mjedisit

PULTI

-ESE-

Me rastin e inaugurimit të monumentit të mjekut Prele Martin Gjeloshit-



Të nderuar pjesëmarrës!

Të nderuar autoritete të pushtetit ven-

dor!

E nderuara Lule, nena e mjekut Prele Gjeloshi!

E nderuara Marie, bashkëshortja e mjeku-

tut Prele Gjeloshi!

Të nderuar Lulash e Doda, vëllezër të

mjekut Prele Gjeloshi!

Të nderuara Tringa e Prenda, motrat e

mjekut Prele Gjeloshi!

Të nderuar të afërm, miq e shoqe të mje-

kut Prele Gjeloshi!

Kam nderin e privilegjin që në kuadrin e

nderimit të mjekut Prele Martin Gjeloshi,

i cili me gjithë forcën e shpirtit bëri për-

pjekje që me punën e dijet e tij u sherbeu

me perkushtim bashkëbanorëve të tij dhe

me gjere, të lexoj sot para jush një ESSE për

krahinën, që e lindi dhe e rriti, që ai e deshi

dhe i shërbeu aq shume, Krahinen e Pultit.

Mund të fillohet herët, por më lejoni të

citoj një pjese nga një shkrim në gazetën

“Luftëtari” e viteve 1976 dhe që e kam

cituar edhe në librin “Dukagjini në rrjedhat

e historisë” nr. 2, në faqen 16-17: “... Një

udhëtar, duke hyrë në Dukagjin, nga Qafa

e T’thores, ndanë rrugës pa një trung me

pamje të trishtuar, i goditur kushedi sa here

nga rrufetë dhe i tha bashkudhëtarit: “ ...

shih mirë këtë trung-skelet e pa krahë dhe

sa herë, në paç udhën për Dukagjin, trokit

në këtë trung se, do të fillojnë të hapen

portat më të lashta të historisë, dhe do të

shikosh se si e kane gjuajtur Dukagjinin

ullore. Për këtë, profesor-doktor Shefik

Osmani, në monografinë “Një misionar në

Shërbim të Kombit”, në faqen 16, shkruan:

“ ... zona e Pultit, ... ka një histori shumë

shekullore të gërshetuar plot ngjarje e që e

bënë atë të përmendur deri në ditët tona.

E mbarsur gjithnjë me kryengritje anti-os-

mane, ajo gjeografikisht pësoi ndryshime

në konturet e kufijve të saj ... së voni zona

u quajt Dukagjin e kështu mbeti deri më

sot. Emisarë të klerit, historianë, gjeografë,

albanologë shkruan për këtë krahinë, si:

Matin Bici, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani,

Korreueli, Thaaloci, Shuflaj, e të tjerë deri

te më të rinjtë Marin Sirdani, Rrok Gurashi,

Justin Rrota, e Benardin Palaj. Ata pohojnë

se kjo krahinë është “fjeshtë Shqiptare”,

“tokë malore” dhe shtrihet “... për gjatë

dromit Shkodër–Prizren ...”.

Historinë e kësaj zone mund ta fillojmë

herët, nga Pultak Gjergji, që në hulumtimet

dhe studimet e baron Franc Nopçes “Fiset e

Malësisë së Shqipërisë Veriore dhe të dre-

jtat zakonore të tyre”, në mes të tjerave, në

faqen 215, shkruan për qytezën e Boksit:

“... ajo quhej kështjella e Boksit, por edhe

kështjella e PULTAK GJERGJIT. Emri Pulatik

është identik me Pultin”. Kësaj të dhenë, i

referohet dhe studiuesi Luigj Shyti, në librin

me titull “Dukagjini, rrugëtim drejt gjene-

zës”, që në faqe 112 shkruan: “... se, ajo

quhej kështjella e Boksit, por edhe kështjel-

la e Pultak Gjergjit. Ky emër vjen nga që, siç

thuhet se, komandanti i kështjellës quhej

Pultak Gjergji.”

Pra, na del përherë të pare një person-

alitet, një figure historike e pa njohur deri

tani. Ky emër del nga goja e këtyre banor-

eve kur Nopce ishte në këto ane apo del

nga studimet e tij? Ketë nuk e dimë. Por,

është një domethënie e madhe se, ky stu-

dim i Nopçes është botuar nga Qendra e

Studimeve Albanologjike në vitin 2013, çka

më bën të besoj se, është më shume një

e dhenë e dale mbi bazën e hulumtimeve

të tij historiko-shkencore, sepse po te ishe

ndryshe do ta kishim dëgjuar edhe ne, dhe

në veçanti që nuk e gjejmë as te studiues

e albanolog të veçante shqiptare dhe të

huaj, aq më pak te ata që kane hulumtuar,

studiuar dhe shkruar për pjesën Veriore të

Shqipërisë. Por, nuk dimë nëse ishte ven-

das apo si i themi sot, i komanduar apo i

emëruar.

Shumë krahina e bashkësi territoriale

ruajtën, në kohen e pushtimit romak, për

një kohë të gjatë një vete-administrim të

brendshëm. Këto bashkësi, të quajtura

qytete, ... në krye të këtyre ka pasur një

prefekt, administrator, që zakonisht zgjidhej

midis ushtarakëve ... Më vonë ushtaraket

romakë u zëvendësuan nga përfaqësues të

parisë vendëse që kishin marrë qytetarinë

romake ... Në burimet shkrimore, përfaqë-

suesit e parisë ilire të vënë në krye të bash-

kësive autonome, ... janë quajtur kryetarë,

ose mbikëqyrës. Pranë tyre ka pasur edhe

një këshill fisnor, i përbërë nga përfaqësues

të ndryshëm të parisë vendëse, që ishin

gjithashtu njerëz të besuar të pushtetit

romak ... Për të lehtësuar sundimin e tyre,

romakët krijuan krahina të mëdha gjuhë-

sore-administrative, të quajtura kuvende-

takim province. Në provincën e Dalmatisë

ka pasur tri kuvende. Në kuvende merrnin

pjesë përfaqësuesit e shtresave sunduese

të qyteteve dhe të parisë ilire të bashkë-

sive territoriale; midis tyre zgjidhej për një

vit, kryetari i kuvendit dhe prifti i kultit të

perandorit. Kjo mënyrë administrimi ka

ndodhur në afërsi të viteve pas Lindjes së

Jezuesit. Dëshirojmë, që një nga këto Kuv-

ende, të jete Kuvendi i quajtur Pulatum ...

Gjithnjë hamendësim, përderisa nuk kemi

ndonjë dokument të veçante ...

Ky territor, a mund të jete formuar si

njësi administrative me herët se shekulli

IX? Siç theksuam, mendoj se, po. Madje

në mënyrë krejt të shkëlqyeshme thuhet se, ka

ketë emërim që nga shekulli i II e mos më

herët. Fatkeqësia është se, deri tani nuk

kemi ndonjë të dhënë, kush ishin sundim-

taret e kësaj krahine kaq të madhe. Burimet

e shkruara antike tregojnë për ekzistencën

në Iliri të disa qendër banimeve të vogla të

fortifikuara, të cilat i quajnë kështjella apo

qytete. Këto kështjella e qyteza ilire ishin

edhe qendra të njësive krahinore të brend-

shme, qytete, ku qenë vendosur paria ven-

dase ... Kampe, me karakter thjesht ushta-

rak, të cilat u ngritën gjatë rrugëve më të

rëndësishme, si në rrugën Shkodër-Puke-

Prizren; Shkodër-Drishte-Lugina e Kirit-qafe

Peje-Plave, apo Shosh-Merture-Krasniqe-

Peje; Shkodër-Kopernik (Koplik)-Tuz-në

thellësi të Zetës, e të tjera, nuk kishin vetëm

karakter mbrojtës, që edhe nëpërmjet

tyre mbroheshin rrugëkalimet, por kishin

edhe qellim qytetërues, zhvillues së banor-

eve të kësaj hapësire. Në ketë hapësire

gjeografike gjejmë sot shume “qyteza”

apo vende mbrojtëse, në tip kështjellash

të vogla, që njihen: Mauriqi (Dakaj), Plani

(Boksi), Kiri, Mgulla, Molla, Kabashi, T’pla

të Krasniqes, Anikena, Varkuni, Lopçi, Shati,

Deja, Sarda (Shurdhahu), Gradeci, Mokseti,

Vuthajt, Drishti, Vauspas, Komani e të tjerë,

në të cilat kanë mbetur pak mbeturina,

dhe mund të jene që në kohën e romakëve,

mos më herët. Në shekujt IV-VI pati shume

sulme barbare, të cilat jo vetëm lëkun-

den sundimin romak në Iliri, por kudo që

kaluan bën grabitje dhe në veçanti shkatër-

rime shume të mëdha. Në historinë e Ilirisë

theksohet: “Në shek. V-VI provincat jugore

e juglindore ilire si Prevali, ... pas shkatërri-

meve e dëmeve të shkatkuara nga invazio-

net barbare u mëkëmbën, madje në shek-

ullin VI patën një farë ngritjeje që u vu re

në shumë drejtime ...”. Por, zbulimi në vitin

2007, në fshatin Theth (në rajonin Grunas),

një vendbanimi të kohës së Bronzit, na

thotë se këto zona kane qene shume kohe

para pushtimit romak të banuara, dhe para

se të formohej Roma, të cilët kane pasur

objektet e tyre mbrojtëse. Pra, këto ndër-

time mund të jene shume më të hershme

se, koha e pushtimit romak apo reformave

administrative të marra prej tyre. E rëndë-

sishme është se, këto ndërtime nuk janë të

rastësishme. Pra, dikush drejtonte, dikush

përgjigjesh për mbrojtjen e sigurimin e

banoreve të kësaj krahine. Po kush ishte ai

apo ajo dinasti?! Të analizojmë ndërtimin

e këtyre kështjellave në disa drejtime: Në

drejtimin Shkodër-qafe Peje: Kështjella e

Drishtit-kështjella e Kirit-kështjella e Planit-

kështjella e Dakajve dhe deri në qafe Peje;

ose drejtimi Shkodër-Podgorice: kështjella

e Lopçit-Gradecit-Moksetit-mali Humit e

të tjera. Këto ndërtime të lidhura në ketë

mënyrë, apo ndërtimi i këtyre kështjellave

apo keshtjellezave, të cilat mbulojnë njëra-

tjetrën në mënyrë prefektë, me siguri janë

udhëhequr nga një strateg ushtarak i mirë-

fillte. Urojme që dikur të gjendet se, diku

duhet të jete e shkruar dhe koha do ta

nxjerri nga thellësitë e shekujve të shkruar,

që t’ia heqin pluhurin e shekujve.

Në dokumentet “Shkrimet shqipe të

viteve 1332-1550”, volumi i trete, faqe 172,

Dhimiter Shuteriqi, në mes të tjerave shk-

ruan: “... Interesi i veçante i këtyre përfaqë-

suesve të kancelarive të huaja, është se në

to pranonin edhe shqiptare, që, sigurisht

bënin përpjekje për t’i dhanë sa më saktë

fjalët shqip, në mos ndiqnin edhe një tra-

dite të shkrimit të gjuhës së tyre amtare.

Me 1349, në Raguze nga 24 sekretar, 20

ishin me origjine nga Tivari, Ulqini, Drishti

dhe Pulti ...”. Pra, e dhëna e kohëve të

fundit, nga Baron Franc Nopçe, nëpërm-

jet librit “Fiset e Malësisë së Shqipërisë së

Veriore dhe e drejta zakonore e tyre”, na

jep detyrimin që të futemi më thelle, për

njohjen e kësaj zone në gjithë thellësinë e

gjerësinë e saj.

Përpjekjet e banoreve të kësaj zone,

për autonomi, për liri dhe për pavarësi, në

kuadrin e gjithë shqiptarisë, janë të përher-

shme. Populli i kësaj zona ka qenë luftëtar

i madh, për të cilët Bonoventure Palacola,

me 1634 shkruan: “... popujt pultianë janë

me shumicë luftëtar ...”; ndërsa Kerubizio

me 1638 shkruan: “ ... pultianët e mba-

jshin për të pa burrni dhe për asgjë atë që

vdiste në shtrat të vet, por të nderuar dhe

trim atë që vdiste nga shpata ... “; ndërsa

Nopça, me 1910 për fitoren e dukagjinasve

kundër forcave ushtarake turke në Qafë

të Agrit, shkruan: “ ... nuk na është luftë e

guerilasve. Shqiptarët i bëjnë ballë trupave

të rregullt në fushë të hapët ...”. Pra, në

ketë kuadër, veçojmë vitet e luftës nën udhë-

heqjen e Heroit Gjergj Kastrioti; të viteve

1630-1639: të viteve 1816-1855: të viteve

1900-1915. E veçante eshte pjesëmarrja

“T’JAM FALE”, DOKTOR FRANI! ... -ese-

Po të përshëndes kështu, doktor Fra Kapaj, si e përshëndesin mikun në shtëpi malësorët, duke ngritur gote. T’jam fale, o mik! Sepse në shkrimin tim ti je miku, je personazhi, je protagonist.

Vendosa të shkruaj për ty, kur të pashe ketë vere, atje, në plazhin e Velipojës, tek u shërbeje plazhitëve që kishin nevojë për mjekun, kishin nevojë për ty. Dhe ti, gjithnjë i palodhur, gjithnjë i devotshëm. Të shikoja nga ballkoni i apartamentit ku banoja, sepse e kisha përballë kliniken ku punoje ti me mjeken Tule dhe infermieren Saime. U shërbeje të sëmurëve jo veç në klinike, por vrapoje edhe tek banesat apo çadrat e tyre, me një gjallëri dhe gatishmëri që të ngjallte veç respekt.

Tek po bisedoja një dite, për ty, në njërin nga lokalet e shumte pranë klinikes, një “birko” tha me ironi: - Nuk po na ndahen dukagjinasi, edhe këtu ne plazhe.- Në vend të përgjigjes unë u ngrita dhe e lashë vetëm, ketë “birko”, që ka ardhur në Shkodër nga fshatrat e Tepelenës,

më vone se ti, por ama fobine perverse ndaj “malokëve” e ka mësuar dhe bere të veten nga politika e ndyre e kafeneve ku lloмотisin injorantet. Ishte e kote t’i jepja leksion historie një kokëshkreti se, Shkodra historikisht, që nga koha e pushimit romak, pastaj otoman e sllav, gjithmonë ka pasur hemorragjinë dhe prurjet e banoreve të saj. Se, Shkodra historikisht është shkrumbuar si zogu Feniks, por është ripërtërire nga hiri i vet pikërisht si Feniksi, duke ndritur, duke u bere edhe më e bukur dhe famëmadhe seç ishte më pare. Dhe se shkodranet e sotëm, të gjithë, pa përjashtim, duke përfshirë këtu edhe “birkon” kane ardhur në ketë qytet, kush më herët, kush më vone. Të gjithë pra, pa përjashtim. Edhe unë, shkruesi i kësaj ese-je, eshtrat e gjyshit tim i kam diku nen themelet e Teatrit “Migjeni” (ka qene një xhami dhe varret e lagjes aty më pare). Por, jam krenar dhe e them me zë të larte se jam nga Kraja, jam krajane. Për hemorragjinë dhe prurjet që ka pasur Shkodra nder mote e shekuj, “birko” le të lexoje Marin Barletin (Rrethimi i Shkodrës) apo profesor Zija Shkodrën (Qytetet shqiptare gjate Rilindjes) apo Stavri Naçen apo Hamdi Bushatin apo ... Veç kam frike se “birko” nuk e “shpenzon” kohen e tij llafazane me lexime. Megjithatë, unë po bej një shkrim të jetës së doktor Franit, që “birko” ta krahasojë me të veten.

Fran Kapaj u lind në Toplanan e largët të Dukagjinit, me 10 shkurt 1961 (sot toplanasi vijnë në Shkodër me “vapor”, sepse buze fshatit është liqeni i Hidrocentralit të Komanit e të Vau-dejës). Shkollën shtate vjeçare e kryen në Toplane, pastaj të mesmen në shkollën Veterinare në

Shkodër. Pas stazhit, është student për mjekësi në Universitetin e mjekësisë në Tirane, të cilin e kryen me sukses në vitin 1986, vit në të cilin u vendos në Shkodër, në lagjen “Skënderbeg”. Punon si mjek në Dukagjin, Toplane. Shale, Shosh, ndërsa ne vitin 1992 është mjek pranë spitalit të



Divizionit të Këmbësores në Shkodër, me gradën major. Në vitin 1998, me kërkesën e tij largohet nga Ushtria, për të shërbyer si mjek në sektorin e Shëndetit Publik në Shkodër, ku punon edhe sot. Gjate kohës që i tepron, ka ngritur një klinike ne Laç të Vau-dejës, ku shërben si mjek menaxher pranë Bashkise atje Kryen detyra shoqërore e shtetërore. Është nder nismëtarët e themelimit të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, me qendër në

Shkodër. Ka mbaruar specializimin për imazher-radiologji pranë spitalit ushtarak Tirane. Në vitin 1995 kryen kursin për organizimin shëndetësor si brenda e jashtë vendit.

Kjo është jeta e doktor Fran Kapaj, që e nderon Dukagjini i tij, por nderohet edhe në Shkodër nga gjithë shkodanet. Tani e ka radhën “birko” si dhe “birkot” e sojit të tij të tregojnë për vete dhe pastaj të bëjnë krahasimin.

Unë e nderoj doktor Franin, si mjek. Nderoj atë dhe gruan e tij fisnike, Lezen, infermiere e nderuar e punktut të gjakut në Spitalin rajonal në Shkodër. Nderoj dy djemtë e Franit e të Lezes, Bekimin e Denisin, të dy me shkolle të larte. Nderoj qëndrimin e tyre stoik dhe shume burrëror për të përballuar humbjen tragjike, në Itali të djalit të tyre të posa diplomuar atje. Qëndrim që për mua është unikall dhe meriton respekt të veçante.

Duke nderuar doktor Franin dhe infermieren Leze, ketë çifte karizmatik, unë nderoj dhe përshëndes përmes tyre edhe miqtë e tjerë dukagjinas, për të cilët jam krenar, si mendimtarin Ndue Sanaj; te shkathëtin dhe të zgjuarin Gjergj Leqeja; “pendetaret” e fuqishëm Lazerin, Prelen Luigjin dhe qershinë mbi torte, shqiptaro-amerikanin dukagjinas, Ndue Ftoni, që aq shume bën për Shqipërinë dhe Dukagjinin e tij në veçanti.

Po e përfundoj shkrimin ashtu si e nisa, me përshëndetje malësore: - T’jam fale doktor Fran kapaj!... Kush të pafte, me nder t’u falte!

Mjeshtri Fadil Kraja,
Shkodër, shtator 2014

(vijon nga faqe 4)

Tani jetojnë 6 prej tyre. Mosha e tyre është nga 94 vjeçe që është Lena fëmija i madh dhe 73 vjeç Leka më i vogëli. Pasurinë më të çmuar që Lulashi jua la fëmijëve është, burrëria, bujaria, ndershmëria e guximi. Por edhe këta ja mbajtën virtytet më të mira. Në një zë ata thonë: Se gjithmonë punuam e jetuam me qëllimin e vetëm për të mos ja korit varrin babës, edhe tash që jemi në moshën e tretë, përsëri thonë te shtëpia e Lulash Malës. Djali i madh Ndoja, në vitin 1949, në provokacionin e 2 gushtit luftojë kundër ushtrisë Greke me trimëri e guxim, për këtë u dekorua me medaljen e trimërisë. Jetojë disa vite në rrethin e Krutës. Vdiq në qafë T’thoresë duke mbete në bore. Marku djali i dytë, po thujse gjithë kohën punojë jashtë Shale. Shumë vite punojë në Tropojë deri sa doli në pension. Kudo u dallua për burrëri e shumë punëtor. Në H/C e Fierzë, është dekoruar me medaljen e punës. U nda nga jeta duke lënë 3 djem të martuar e me familje, dy prej tyre jetojnë në Itali. Pëllumbi është djali i tretë i familjes. Gjithë jetën punojë në shtet, fillimisht mësues, pastaj bëri shkollën e

doli teknik në Ndërmarrjen e Grumbullimit në Shkodër. Pëllumbi është i njohur jo vetëm në Dukagjin, Malësi të Madhe, Shkodër e më gjerë. Me shkrua për të duhen me dhjetëra faqe. Por i qëndrojë intervistës marrë disa kohë më pare nga z. Luigj Shyti. Fëmijët i ka të martuar e të rregulluar shumë mire, dy djemtë jetojnë në Angli. Djali i katërtë, Mhilli ka punuar e jetuar në rrethin e Tropojës. Dallohet si burrë i pashëm e punëtor, u dallua si specialist në Ndërmarrjen e Përpunim drurit, ku fitojë respektin e kolektivit. Fëmijët i ka të rregulluar shumë mire. Të gjithë punojnë në Perëndim. Djali i pestë, Gjoka, i cili i qëndrojë besnik vendlindjes, pra u bë shtylla e shtëpisë së Lulash Malës, me burrëri, bujari e ndershmëri. Pra, siç e donte i ndjeri Lulash. Gjoka u martua me Bardhën. Vajzën e Tom Kolës në shtëpi të Bal Markut në Mekshaj të Shalës. Një çifte ideal, sikur kishin lindur për njëri tjetrin. Këta linden e rriten 8 fëmijë, 4 djem e 4 vajza. Edukata e tyre është për tu admiruar, jo vetëm nga pamja, por edhe nga sjellja i njehtë se të kujt janë. Gjashte prej tyre jetojnë në Perëndim, 4 djem në Angli dhe 2 vajza njëra në Greqi

e tjetra në Itali. Krahas punës bërë nga prindërit, meritë ka djali i madh i Gjokës, Pali i cili, mundësojë edhe emigrimin e 3 vëllezërve të tjerë në Angli. Gjoka në pamjen vizuale nuk të jep moshën as për të 60-tatë, ndonëse ai ka plotësuar plotë 76 vite. Në kooperativë bujqësore nuk ishte e lehtë të administroje një familje prej 20 vetash, pa përmendur këtu miq e bija e të tjerë. Duhesh pritë e përcjell siç ka pas në traditë kjo familje. Gjoka kujton një porosi të babës i cili thoshte: “*Oborin e rrethimin rregullojë për armiq të shtëpinë për miq. Ai, që nuk të done, nuk të hynë në shtëpi, por rrinë në oborr dhe kur e shef keq i bëhet qefti. Ndërsa miku të vjen në shtëpi edhe po nuk e gjeti në rregull ai nuk ka si të bënë për fjalësh*”.

Kjo familje e madhe, ku vetem fëmijë ishin 13, kërkonin ushqim, veshmbathje e mbi të gjitha edukimin, për të mësuar mire në shkollë e te tjera. Asnjë nga djemtë e vajzat, nipat e as mbesat nga trungu nuk kanë mbaru shkollat e larta, Gjergji mbarojë shkollën e ndërtimit shkëlqyer, por nuk i dhanë burse për të lartën. Në vitin 1968, Gjokës i del bursa për në shkollën e mesme ekonomike në Berat. Nuk e

lejon paria e fshatit për ta vazhduar se ka biografin e keqe. Megjithatë e mbarojë shkollën e mesme bujqësore natën me nota të shkëlqyera, duke udhëtuar tre herë në javë nga 3 orë në këmbë. Biografia e keqe kësaj familje i vinte se Lulash Mala pati bërë 6 muaj burg për agitacion e propagandë. Në kooperative bujqësore ka punuar brigadier e llogaritar e te tjera. Në demokraci e angazhuan si burrë i mençur në pajtim gjaqesh, zgjidhje konfliktesh e hasmërisë e te tjera. Leka, djali i gjashtë edhe ky po thujse gjithë jetën punojë në rrethin e Tropojës, specialist ndërtimi. Duke pasur unitet në mes tyre dhe për të qenë të bashkuar. Sot jetojnë të gjithë në Ishull-Shëngjin, duke përjashtuar Pëllumbin, i cili jeton në Shkodër. Janë të rregulluar shumë mirë, me shtëpi vila e makina luksoze e te tjera. Kryesore është se nuk u mungojnë burrëria, bujaria e ndershmëria te trashëguan nga të parët e tyre. Po këta janë duke i lënë trashëgim brezave pasardhës.

Përgatitur nga **NDUE ZIÇI**

◀ e Planit”, për të cilën ka meritën e veçante. Mirënjohje kolegu im, Nenkolonel Mhill Pali!

Pulti, në çdo fushe të jetës ka pas personalitetet e figurat e kohës. Pulti ka nxjerre klerik që jo vetëm kane qene të suksesshëm në shërbim shpirtërore të banoreve ku kane punuar, por kane qene dhe personalitet të kulturës shqiptare, që në mes të tyre mund të veçojmë Profesor doktor Luigj Marlekaj apo At’ Jak Marlekaj nga Plani, i cili ka qene profesor i gjuhës shqipe në Universitetin Bolonjës, Milanos dhe për

30 vjet në atë të Barit. Për këtë, në veçanti Profesor doktor Shefik Osmani ka bere një studim dhe është i botuar në një libër, me titull “Një misionar në shërbim të Kombit”. Edhe Shoqata “Atdhetare-Dukagjini”, në muajin nëntor 2006, në kuadrin e 100 vjetorit të lindjes së tij ka organizuar një simpozium shkencor të veçante, në bashkëpunim me pedagog të Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, dhe materialet e tij janë botua në një libër po të veçante, me titull “Dukagjini në rrjedhat e historisë”, nr. 2. Gjithashtu, mund të veçojmë kapiten Vas

Kirin, socialdemokrat in e Pare Zef Malaj, luftëtaren e emancipimit të femrës shkodrane, Zina Franja, Admiralin Mark Plani, Artisten e Popullit Tinka Kurti, Artistin e Popullit Ndreku Luca, këngëtarin Pëllumb Tefa e shume të tjerë e të tjerë personalitete të artit e të kulturës sonë. Edhe mjeku i ynë, Anetari i Nderit të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, Prele Martin Gjeloşi ishte dhe mbetet pjese e tyre, në rresht me ta, me të cilët jemi krenar ne dhe do të jene krenar edhe brezat e ardhshëm.

Të nderuar pjesëmarrës, është e vështirë

të ligjërosh për Pultin dhe për gjithë zonën e Dukagjinit, sepse kjo teme kërkon disa kumtesa të veçanta për t’u publikuar, ose thënë e gjithë historia e saj. Gjithsesi, ju kërkoj ndjese për këtë që iu paraqita se, ndoshta ndonjëri nuk mendon siç mendoje unë, por dhe për kohen që ju mora!

I përjetshëm qofte kujtimi i jetës dhe punës së mjekut Prele Martin Gjeloşi!

Ju faleminderit!

Nga historia shqiptare e Anadollit dje...

(vijon)

Një kapitull më vete përbën tjetërsimi, boshatisja këto 70 vjetët e fundit nga shqiptarët e Sanxhakut me kryeqendër Tregun e Ri (Novi Pazar) dhe largimi masiv prej pllajës së Peshterit. Është një emigrim i vazhdueshëm, i pashembullt drejt Stambollit e qyteteve kryesore të Turqisë si Bursa, Izmiri, Ankaraja e të tjerë. Vetë kam folur shqip më 1989 me të rinjtë e Pazarit të Ri në Kapallë Çarshi (Pazari i floririt) që kishin ardhur e ishin punësuar në Turqi. Largim, largim, kurbet, deri kur?! Formimi i shteteve të pavarura të Ballkanit ka pasur koston më të lartë për shqiptarët që kanë qenë të detyruar të marrin rrugët e mërgimit me hir apo me pahir...

Ka edhe një ç'vendosje të padukshme, **të katërt të madhe**, madje do të thosha të stërmadhe të shekujve, për të cilën kurrë nuk do të ketë shifër të saktë, por bëhet fjalë për qindra e mijëra shqiptarë që mbeten në dhë të huaj, qoftë lanë kockat, qoftë zunë vend aty, krijuan familje e nuk e panë më tokën që i lindi, atdheun e tyre. Është fjala për aspektin ushtarak qoftë si shërbim i detyrueshëm, qoftë si profesion, si ushtarë me pagesë ose të njohur ndryshe si mercenarë. Me të drejtë Robert Elsie flet për **“emigrimet e hershme të shqiptarëve në Turqi si rezultat i rekrutimeve me forcë për ushtrinë osmane dhe jeniçerë”**. Gjatë pesë shekujve të sundimit osman në trojet etnike, shqiptarët kryen shërbimin ushtarak në të katër anët e perandorisë, me një sipërfaqe mbi 15 milion km² të shtrirë në tre kontinente. Kënga e “Urës së Qabesë” është sinjifikative në këtë drejtim ... Shërbimi vazhdonte, në disa raste, deri në 10-15 vjet dhe, ose linin kockat në shkretëtirat e Arabisë, Jemenit, Sirisë, Veriut të Afrikës si në Egjipt, Libi e gjetkë, ose vendoseshin andej.

Një plagë e pambyllur, e nisur që në shekujt bizantinë e që vazhdoi edhe në shekujt osmanë, është mercenarizmi që e kanë kaluar shqiptarët pa dallim feje. Dy janë popujt në Evropë që armën e kanë pasur të shenjtë dhe që jeta e malet ku jetonin, i diktonin e i detyruan të mos e hiqnin nga supet dhe luftën ta bënin profesion të tyre se, vendi nuk i mbante: Shqiptarët dhe Zvicernarët. Katolikët e zonës së Krajës mbi Shkodër e Ulqin, e kanë kryer shërbimin ushtarak tradicionalisht në Gardën e Sulltanit, madje me veshje karakteristike të krahinës së tyre.

Shqiptaret në Turqi dhe gjuha

Shqiptarët katolikë të Veriut, shqiptarët ortodoksë të Jugut e të Moresë, që kapërcyen detin në Itali, në shekullin XV shërbyen si stratiotë (ushtarë me pagesë) në ushtritë e perandorëve e mbretërve dhe princërve të Evropës Perëndimore. Këtë traditë e vazhduan po në Perëndim, në shekujt osmanët shqiptarë ortodoksë të Himarës, Labërisë, Suljotët e Çamërisë e të tjerë. Në Lindje, në Rumani, shërbyen shqiptarët ortodoksë të Shqipërisë së Jugut e të malësive të Korçës, Pogradecit, Strugës, Ohrit, Kolonjës, Përmetit, Dangëllisë, Gjirokastrës e të tjerë. Ata qenë ushtarë rrogëtarë, në shërbim të gospodarëve (princërve fanariotë

shqiptarë si Gjikajt, Dukajt e të tjerë) në principatat e Vllahisë e Moldavisë. Labëria, edhe kur u islamizua, vazhdoi zanatin e “gjakut”. Anglezët, francezët e të tjerë kolonizatorë, kanë rekrutuar për llogari të tyre mercenarët shqiptarë e i kanë dërguar pas përgatitjes stërvitore ushtarake në Afrikë e gjetkë. Shqiptarët me fustanella, sidomos nga Jugu i Shqipërisë po edhe Veriu, kanë luftuar me pagesë edhe për llogari të Mehmet Aliut, kur ai u bë pasha i Misirit (Egjiptit) edhe në shkretëtirat e Sirisë, Sudanit, të Arabisë, Libisë e në vende të tjera, ku e solli hera. Nuk është e rastit që në një sërë tablosh të piktorëve të shquar anglezë e francezë e të tjerë, kur tregohen luftërat në Afrikë apo në Lindjen e Mesme, paraqiten shqiptarët me fustanella të bardha dhe qeleshet karakteristike në kokë. Shërbimi ushtarak dhe mercenarizmi përbëjnë ç'vendosje të katërt të madhe të shqiptarëve, atë të largimit nga trojet amtare

fra rreth **15 milionë pa treguar burimin**. Ka burime të tjera që japin shqiptarët ¼ apo 1/3 e popullsisë aktuale të Turqisë. Sipas një të dhëne çdo i treti banor i Turqisë pavarësisht e flet shqipen apo jo, si gjuhë amtare, është i gjakut shqiptar. Kohët e fundit janë shtuar botimet arkivale për popullsinë e zbritur në Republikën e Turqisë nga Rumelia d.m.th. Ballkani. Ka që e shpien shifrën e të ardhurve prej këtej në Anadoll, deri në gjysmën e popullsisë së tij, apo që përbëjnë rreth gjysmën e popullsisë totale të Turqisë. Këtë autori i këtyre rreshtave e ka dëgjuar edhe nga specialistë demografë në simpoziume e kongrese shkencore të mbajtura si në Jeshilqoj apo vende të tjera. Po të gjykojmë nga këto shifra, duke marrë parasysh dhe shtesën e madhe natyrore të popullsisë së re në Turqi, shikon se shifrat që u dhanë më sipër nuk janë dhe fort larg realitetit, apo e thënë ndryshe nuk janë dhe aq të papranueshme. Gjith-

burimin tjetër, albanologu Elsie i shtonte sqarimin, “shumica e të cilëve me origjinë kosovare”. U takon studiuesve kompetentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, shqiptarëve të Turqisë dhe shtetit turk, që ka statistikën e plota të brendshme, për të thënë një fjalë më të plotë dhe kompetente edhe në këtë drejtim. Kjo i takon së ardhmes. Ne, vetëm kaq mund të themi përafërsisht mbi bazën e burimeve direkt apo të dhënave indirekte që disponojmë ... Mendohet s,e vetëm qyteti i Stambollit ka mbi 3 milion shqiptarë në një kohë kur ai, u është afruar rreth të 20 milionëve. Është qyteti me më shumë shqiptarë në Ballkan, për t'u ndjekur nga qytete-metropole si Tirana dhe Shkupi dhe, tash së voni, edhe Prishtina.

Për ngjashmërinë apo më mirë njëjtësinë e shqiptarit apo njeriut të Ballkanit me shqiptarin apo njeriun e Anadollit të tjetërsuar në gjuhë e të tjerë, flet e do të flasë më mirë në të ardhmen



... Duke e ndalur fokusin e vështimit tonë në dy gadishuj, atë të Anadollit dhe Sinisinë Ilirike (Gadishulli i Ballkanit siç njihet sot) mund të themi si konkluzion të shtjellimit të kësaj pjese të parë të punimit tonë se, pavarësisht nga gjuha, që ka të bëjë me tjetërsimin e shqiptarit që ka jetuar në këto hapësira, si greqisht tek arvanitët, turqisht tek arnautët, kemi të njëjtin njeri. Antropologjia do të kishte se çka të fliste.

Shifrat për popullatën shqiptare që jeton në Turqi shkojnë nga **3 milion deri në 20 milionë** (shifra zyrtare nuk ka por dhe kur jepen janë qesharake, rreth 50 000 veta, më e larta e dhënë në një botim të fundit deri më sot). Regjistrime, statistika në këtë drejtim për popullatën shqiptare nuk gjenden kurrkund. Gjithçka është e diskutueshme në shifrat që jepen andej këtej. P.sh. gjatë vizitave në Shqipëri të presidentëve turq, pas vitit 2000, për shqiptarët e Turqisë janë dhënë nga goja e tyre **shifrat 53 dhe 64 milion**. Në një emision të kanalit televiziv Top Channel për shqiptarët e Turqisë është dhënë shi-

sesi, problemi mbetet i hapur....

Po sjellim edhe të dhënat nga dy burime që i takojnë të njëjtë studiues, kanadezit Robert Elsie, të cilat na ranë në dorë tani së fundi, kur po i vinim pikën këtij artikulli studimor. Në të parin, në zërin “Turqia, shqiptarët në Turqi” ai shkruan dhe këto (lexuesi le të gjykojë vetë si për informacionin e sjellë, ashtu dhe për autorin): “Ndonëse jo shumë i njohur jashtë dhe pavarësisht mungesës së statistikave të besueshme për popullsinë, komuniteti shqiptar në Turqi, në të vërtetë mund të jetë më i madhi në diasporë. Emigrimet e hershme të shqiptarëve në Turqi ishin rezultat i rekrutimeve me forcë për ushtrinë osmane dhe jeniçerë ... Numri i shqiptarëve etnikë, (d.m.th nga Ballkani-L. B) në Turqi mund të arrijë mbi një milion, ndonëse shumë prej tyre janë asimiluar. Një raport i Këshillit të Sigurimit Kombëtar të Turqisë, më 2008, vlerësonte se në Turqi jetonin 1, 2 milionë shqiptarë. Sidoqoftë, ka ende komunitete të mëdha dhe aktive shqiptare në Stamboll dhe Bursë”. Kësaj shifre (1, 2 milion), në

antropologjia, etnografia, folkloristika e shkenca të tjera. Mjafton të krahasosh instrumentet muzikorë si çiftelia, gërneta e të tjera apo veshjet e një popullate të Detit të Zi, siç janë llazët, këngët, vallet, lodrat e tyre të ndryshme e të bindesh se, sado larg të jenë këto vise gjeografikisht nga njeri-tjetri, prapë janë afër, shumë afër në doke, në zakone, në tradita.

Me sy të lirë, vetëm duke parë muzeun e qytetërimeve anatoliane në Stamboll, muzeun e pasur arkeologjik të Bursës, muzeun arkeologjik të Antalias, muzeun e arkeologjisë së nënujit në Bodrum në brigjet e Egjeut e të tjerë, dhe t'i krahasosh me muzeun arkeologjik të Tiranës, s'e ke të vështirë të realizosh se, në një kuptim, në të dy gadishujt ka jetuar e njëjta popullsi iliro-pellazge. Kur mësonite gjuhën turke në Stamboll, autori i këtyre rreshtave, në tekstin e mësimi shihte një fotografi me varre monumentale në zonën e Izmirit, në atë që njihet si “rrethi mavi (blu)” dhe që kap më së shumti brigjet e Egje-Mesdheut deri në Antalia. (vijon)

QYSH I RI ME PILOTIN NDUE LOGU

Kujtime

Rinia ime e hershme e ka përcjellë si një legjendë këtë emër, sepse Ndeu Logu si një aviator i zoti e ne zë kishte mbërrit deri në Kommanin tim të largët. Më vonë në Shkollën Pedagogjike në Shkodër njoha shumë dukagjinas, që ndjenin krenarinë e të qenies prej një ane me pilotin Ndue Logu dhe ndryshe nga unë, ata tregonin ngjarje të fluturimeve e uljeve të helikopterit në Breg të Lumit Shalës, se si ata kishin përjetuar këtë moment që ishte tepër emocional për një malësor të vogël të shihte një aparat fluturues dhe pilotin e tij, ta preknin me dorë e ta përshëndesnin. Sa herë shikoja helikopterë, por edhe avionë që fluturonin mbi kokat tona, në mendjen time vizatohej ky emër e ky pilot, anipse ishin edhe të tjerë që pilotonin, por përherë zemrën ta ngacmon Ai, i njohuri që të duket më i afërti, më vëllai.

Rasti solli që të shkoja edhe unë në Shkollën e Aviacionit për pilot në Vlorë.

Pas disa ditësh, kur u njoha me shokët dhe profesorët, nuk munda të rri pa pyetur për aviatorin Ndue Logu. - Po - më thanë - e njohim, por ai nuk është këtu, është në Tiranë, në Regjimentin e Helikopterëve. I falënderova për informacionin dhe vazhdova jetën e përditshme të studentit për përgatitjen teorike e më vonë praktikën fluturuese.

Në vitin 1970 filluam fluturimet si fill-estarë në avionin mësimor Jak-61 (fabrikimit rus), ndërsa studentët e dy viteve para nesh, fluturonin në Mig-15, që ishin avionë reaktivë duke u përgatitur kështu për të kaluar në fluturimet e mëvonshme në aeroplanë luftarakë të shpejtësive të mëdha e supërzanore, siç ishin Mig -19 dhe Mig - 21. Pikërisht gjatë këtyre stërvitjeve në gusht të vitit 1970 ndodhi një ngjarje e jashtëzakonshme; gjatë pilotazhit në figura vertikale mbi zonën e Fierit në lartësinë 6000 m, avioni reaktiv i drejtuar nga student i vitit tretë Valter Garga bie në një pozicion të vështirë e të pakomandueshëm, shto për ose turjelë quhet në gjuhën e aviacionit dhe me gjithë tentativat e studentit pilot, dalja nga ky pozicion ishte e pamundur, por rriste shpejtësinë vertikale në drejtim të tokës. - Hidhu me katapultë (parashutë) - ishte zëri në kullën e drejtim, zë që u përsërit disa herë radhazi derisa në kufje arriti vetëm një “kerrik” dhe pastaj heshtje.

Të grumbulluar rreth kësaj pike të vogël komanduese, që të gjithë ne e quanim “kullë e udhëheqësit fluturimit”, ndiqnim si në një kronikë të imagjinuar fundin fatal që mund të kishte shoku ynë student dhe njeriu ndjehet shumë herë më keq, kur mundësia për të dhënë një ndihmë konkrete mungonte plotësisht dhe i vetmi mjet që mund të ndërhynte në këto raste ishte helikopteri.

Orët kalonin dhe ankthi rritej. Ishin ndërprerë të gjitha fluturimet dhe avionët të rreshtuar me helika që nuk lëviznin e turbina shurdhë i jepnin edhe më shumë pamjen e trishtuar kësaj dite, e cila mund të ishte e veshur në zi dhe këtij aerodromi të mësuar përherë vetëm me zhurma. Ndërkohë helikopteri i nisur nga Tirana kishte arritur në vend-ngjarje dhe vazhdonte të bënte kërkime në zonën ku mendohej rënia e pilotit dhe e avionit reaktiv. Unë u ndodha pak larg pikës duke diskutuar me shokët ngjarjen, kur dëgjuam një “urra” që doli nga zemrat e gjithë të pranishmëve: “Është gjallë, është gjallë, Valteri jeton, është shëndosh”. Ky informacion ishte dhënë me radio nga pilotët e helikopterit që pas pak do ta shikonim këtë

mjet shpëtues si një pikë në qiell që vazhdon-te të rritej deri në uljen e pushimin me katër rrotat mbi tokë dhe shikonim me sy nga dera kur po dilte studenti Valter Garga, i cili deri një orë më parë në mendjen tonë ishte vetëm një enigmë që fluturonte edhe njëherë duke u ngjitur drejtë qiellit nga kishte zbritë minuta më parë, por tani vetëm si shpirt.

I veshur me rrobat e fluturimit, me një trup të shkurtër eci ngadalë mes nesh si një mrekulli që vinte nga qiejt. Zbriten edhe pilotët nga kabina e helikopterit. Ishin dy burra të pashëm, por njëri më i gjatë e me një trup krejt sportiv. “Do të jetë Ndue Logu ky i gjati” thashë me mendje. Këtë ia përsërita edhe shokut tim Sami Guzina, që rrinte përkrah meje. Pas gjithë asaj situatë të krijuar, kërkonte kohë që njerëzit të rimerrnin vetën e kjo kohë vlejti për të sqaruar të gjithë ndodhinë se si Valteri ishte hedhë me katapultë, se si avioni ishte ngulë në tokë, sa nuk i dukeshin as edhe pjesët e kështu pak nga pak u sqarua ngjarja, por mbi të gjitha studenti ishte midis nesh.

Pas disa orësh pashë se piloti i helikopterit, ai më i gjati, u largua nga grumbulli dhe ndezi një cigare nën hijen e pishave të shumta që mbulonin kampexhin tonë. U afrova ngadalë e pak si me ndrojtje. E përshëndeta duke e pyetur se a ishte vetë ai Ndue Logu. Buzëqeshi e më afroi duke më vënë dorën në shpatull e pastaj më pyeti nga isha. “Prej Komani” - i thashë. “Po si je more malcuar?” - m’u drejtua tamam si burrat e motit. Folëm gjatë dhe u ngroha në shpirt kur lexova ndër sytë e tij kënaqësinë që shprehnin, kur po shihte para tij një tjetër verior që kërkonte të bëhej pilot. “Të pres në Tiranë të helikopterët, kur të mbarosh programin këtu” - tha duke më përqafuar. E ndjeva gjatë atë përqafim prej vëllai atje në Vlorën e largët, ku asnjë nga të afërmit e mi nuk patën mundësinë të më takonin të paktën njëherë, ndërsa duart e krahët e atij burri ishin për mua gjithçka.

Ia dëgjova fjalën komandant Ndues. Së fundi u ndodhëm të dy bashkë, në një llogore, si i thonë, por unë vazhdoja përgatitjet edhe për disa kohë si student për të mësuar edhe helikopterin, ndërsa ai pilot i plotformuar në të gjitha aspektet.

Bënte shumë shërbime gatishmëri numër një për të qenë i gatshëm për t’u ngritur në ajër çdo minutë që mund të thirrej helikopteri në ndihmë të popullsisë e të urgjencave në të katër anët e Shqipërisë.

Një darkë pranvere u ndodhëm vetëm në pistën e brendshme të kazermave. Folëm gjatë. I tregova e më tregoi jetën, peripecitë që kisha kaluar për të ardhur deri aty, por mbeta si i turpëruar kur më foli ai për jetën e vet. I rritur jetim, pa baba e për një kohë të gjatë në shtëpinë e fëmijës, pastaj rrugëtimin për në Bashkimin Sovjetik. Mungesën tërësisht të komunikimit me të afërm, larg atdheut, as një letër nuk mori, por me tha se “pas disa kohësh qëndrimi në dhë të huaj, më kishte marrë malli shumë e në fund të valixhes gjeta një gazetë shqip që kisha mbështjell teshat kur u nisa për jashtë shtetit. E kam lexuar e sterlexuar këtë gazetë, sa edhe sot e di përmendësh” mandej vuri buzën ne gaz, sikur të thoshte “he të kaluara”. U preka në shpirt për dhimbien që kishte hequr ky burrë malësor e që fliste një gjuhë krejt të pastër viorë e të papërzier me dialekte dhe që e kuptonte jug e veri.

Ecën vitet. Ndoja pati një karrierë të shkëlqyer, falë aftësive vetëm të tijat, mbaroi akademinë ushtarake dhe u kthye komandant skuadrilje, pastaj Zëvendës Komandant Regjimenti për fluturimet. Duke qene në detyrën më të lartë të fluturimit, me një ndjenjë e përgjegjësisë për fatin e shokëve kur shkëputeshin nga toka e nisinin fluturimin, për përpikërinë në dhëniën e urdhrave që edhe një e mijta e sekondës të shpëton o të merre jetën, vendim marrja në situata të vështira të kohës e terrenit dhe nga ana tjetër disiplina formale e krijuar artificialisht vetëm për ti ulur kokën edhe profesionistit më të mirë; të

gjitha këto krijuan një stres që pak nga pak iu kthye në sëmundjen e presionit të lartë të gjakut, gjë që është pika me rrezik e çdo aviatori. Dhe Ndue Logu, heroi i fluturimeve, piloti i talentuar dhe miti i ajrit detyrohet të lërë zanatin që e deshi aq shumë dhe të largohej prej qiellit me flatra të plagosura.

Me komandant Ndue Logun bëra qindra fluturime në përbërje si ekuipazh nëpër stërvitje e detyra të ndryshme speciale, por gjithmonë në kujtesë të mbetet fluturimi që ka lënë mbresa më shumë dhe që mbeti i fundit për të. Ishte janari i vitit 1985, që solli një mot me reshje bore duke bllokuar të gjithë zonën e veriut dhe detyra kryesore iu ngarkua Regjimentit të Transportit helikopter në Farkë për transportimin e mallrave ushqimore për në zona të thella malore. Ekuipazhit ku bëja pjesë unë i u ngarkua detyra për të çuar ushqime nga stadiumi i Shkodrës për në Mollë të Shoshit, ne Dukagjin. Me të drejtë të Zotit them se ishte një ndër detyrat më të vështira si terren e po ti shtojmë edhe borën që kishte mbuluar gjithçka, përgjegjësia shtohet shumëfish e gati në të pamundurën, por... detyra, e kësaj nuk i shmangesh dot. Komandant Nduja, tashmë një vit i privuar nga fluturimi, kishte ardhur në aerodromin e Laprakës, ku ishim dislokuar, me vullnetin e vet të mirë për të dhënë ndihmën e tij si ekspert me përvojë të gjatë fluturuese. Më shikon mua të shqetësuar e më afrohet duke me pyetur se për ku ishte detyra. I thashë se është për në Mollë të Shoshit, por unë po mundohem të përgatis rrugëkalimin në hartë e të hedh kurset, se e kemi të vështirë edhe ta gjejmë. Më shikoi drejtë e në sy, ku pasiguria ime shihej prej larg. Ai kapi hartën që unë po hidhja vijat e kurset e fluturimit e ma palosi. “Fute ne planshete” me tha “se do të vi unë me ju”. I gjithë ai zor e tensionim, gjithë ai stres që po ndjeja deri atëherë u shkrinë menjëherë para këtij burri, sa po më vinte ta merrja në krahë bacën Ndue e ta shëtitja nëpër aerodrom.

U nisëm për të ngarkuar mallrat e sidomos bukë në Shkodër e mandej në Mollë. Ai qëndronte mbas shpinës time si “pasagjer” kësaj radhe dhe unë ndjehesha më i sigurt se kurrë në një detyrë të vështirë si kjo. Pas ngarkesës u ngritëm në ajër. Gishti tregues i Ndues ishte navigatori më i përpiktë i botës e i rrugëkalimit që do të ndiqnim. Gryka e Kirit dhe shpati i Cukalit ishin mpirë nën peshën e borës bardhë dhe Nduja i kënaqej këtij peizazhi që dikur në fëmijëri e kishte kaluar disa herë në këmbë. U shfaqën me radhë muret e larta të maleve nga të dy anët e Kirit; mali i Fezës, i Buallit 1383m, i Bigës 1325 m dhe nga ana e majtë e fluturimit tonë lartësoheshin malet e Bishkasit, 1870m, i Mguillës e deri të mali i Boshit e qafa e tij që shtrihet mbi fshatin e bukur Nënnavriq nga krahui i luginës Lesniqës. Lartësia e fluturimit ishte vetëm 200 m mbi relief, pasi me sipër fillonin retë. Sapo kaluam qafën 900 m që krijohet nga mali i Bigës dhe i Buallit, pikërisht aty ku ndahen ujërat e lumit Kiri me lumin e Shalës, para nesh u shfaq lugina e Lesniqës me gjithë madhësinë e vet, sa asnjë piktor, fotograf a penë nuk mund ta përshkruaj këtë bukuri të rrallë. I habitur pas kësaj pamje, dëgjova në vesh fjalët e Ndues që fliste me zë të lartë, pasi zhurma e madhe e motorit nuk të le të komunikosh drejtë për drejtë: “A e din kush asht ai fshati në shpat të malit që shihen tymrat e oxhaqeve?” tha ai. Unë e kuptova menjëherë që bëhej fjalë për Brashtën e tij dhe iu përgjigja aty për aty: “Është çibuku i Gjonit Brashtës që nxjerr tym” dhe në kabinën e vogël të pilotimit plasi e qeshura. (Gjon Marashi, figurë popullore dhe xhaxhai i Ndues). Përball na priste Molla e Shoshit, me pak shtëpi dhe me një shesh fare të vogël, sa ishte e pamundur ulja e helikopterit. Vendosëm që thasët me ushqime ti hidhnim nga ajri duke bërë një manovër deri afër tokës e me ngadalësim shpejtësie deri në 50-60 km/orë. Tekniku i helikopterit Masar Lengu hapi derën e përgatiti lëshimin e vetëm të disa mallrave, pasi koha nuk prem-

tonte për më shumë. Kalimi i parë u bë me sukses dhe u bëmë gati për manovrën e dytë. Peshat e hedhura nuk dukeshin më, pasi i përpiu trashësia e borës dhe këtu ndodhi diçka pak si me rrezik. Fshatarët, duke menduar se kaq ishte, vrapuan për të tërhequr mallin dhe kur ne po përgatiteshim për hedhjen e dytë, populli ishte aty nën helikat tona me thasë në krahë e nuk largoheshin dot me vrap nga pengesa e borës, kështu që ne bëmë një kalim bosh, se ndryshe thasët me bukë do të zinin njerëzit poshtë. Kështu u krye kjo detyrë fare thjeshtë, falë ndihmës madhore të Ndue Logut, ku vetëm një faleminderës e humb kuptimin në krahasim me atë që bëri ai. Në kthim kaluam luginës Drinit, se nuk mund të ktheheshim pa përshëndetur edhe Kommanin tim.

Komandant Ndue Logu duke qenë i ri, i përgatitur si akademik, pas ndërprerjes si pilot, u mendua të kalonte në një detyrë tjetër tash ma jo si fluturues, por si shef i armatimit të Regjimentit, detyrë kjo që do ti merrte jetën. Atë që s’ia bëri ajri, lartësitë, fluturimet në Mezhgoran e në Lekbibaj, në Sopot e në Maqellarë, në Vukël e në Krumë, në terren të vështirë e në kondita të rënda meteorologjike, në borë e shi, ditën e natën, ja bën një cifël granate e hedhur pa kujdes nga një ushtar gjatë një stërvitje të rëndomtë në poligon, e cila i godet aortën e zemrës. Edhe këtu ai tregoi burrërinë, trimërinë e mbi të gjitha karakterin e malësorit, duke shpëtuat ushtarin e duke u vrarë vetë. Në momentin që ushtari i kishte hequr siguresën, granata i shpëton nga dora e bie te këmbët e tyre. Nduja arrin të shtyj ushtarin dhe të kap granatën për ta rihedhë, por sapo e shkëputë nga dora në një distancë rreth 2 m granata pëlçet duke depërtuar një cifël deri te aorta e zemrës.

Edhe me aortë të këputur ishte ngritur në këmbë, vendos dorën të zemra që i kullonte e shqiptoi vetëm një fjalë: “ Uuu gjak” dhe ra për të jetuar si një dëshmor e si një hero.

Kjo ishte një tronditje e thellë dhe humbje e dhembshme për familjen, për të afërmit, për të gjithë ne, nxënësit e vartësit. Vite më vonë bashkëshortja e Ndues, Vera më tregon: “Edhe unë jetoja me shqetësimet e tij, sidomos të fluturimit e të vështirësive që kalonte. Kur u shkëput si pilot, gati kaloi në depresion, por unë i qëndrova shumë afër e aq më tepër të dy vajzat që ishin jeta e tij. Një natë para se të vritej ishte si në gjemba, si i thonë, dhe më bëri me dije për një qitje të zorshme që do të zhvillonin të nesërmen me granata për stërvitjen e ushtarëve, por unë, që ja dija karakterin, ku edhe në këtë pikë donte të ishte i përsosur, i thashë se për ty kjo nuk është asgjë, kur ke kaluar vështirësi shumë më të mëdha. Kështu u mbyll si me të qeshur kjo natë. Të nesërmen dëgjova një zhurmë helikopteri që po ulej në Spitalin Ushtarak, ku unë punoja si infermiere dhe zemra më rrahu me forcë, sa gati mu errën sytë. Menjëherë pyeta kolegët se ç’ka ndodhë, por të gjithë m’u bënë barrikadë te dera e nuk me lanë me dalë. Unë këmbëngula dhe pas disa çastesh me vjen drejtë e më thotë të vërtetën. Edhe sot e kësaj dite e kam parasysh këtë helikopter, i cili po fluturonte me Ndue Logun, por kësaj radhe vetëm me trupin pa jetë te tij”.

Tetë vjet pas lënies se detyrës për arsye shëndetësore nga Ndue Logu, më takoj mua të emërohem po në këtë post, si Zëvendës Komandant Regjimenti për Fluturim dhe sa herë që helikopterët niseshin në detyra, sa herë që organizohej fluturim e sa herë që komandoja në kullën e drejtim të fluturimeve, më tingëllonin në mëndje fjalët e shkruara prej dorës tij në librin e analizave të detyrave fluturuese: “O shok që do të më zëvendësosh! ... Detyra e udhëheqësit të fluturimeve është detyra me serioze, më e vështirë, më me emocione, më e kënaqshme, ku nuk duhet të gabosh asnjë sekondë ...!”

(Libri i analizave të fluturimeve Nr 150, date 29 / 07 / 1984).

Piloti në pension, N/ Kolonel NDOC SELIMI

Dashuria në pendën Dukgjinase"



GJARPRI E GRUEJA

Ajo mbramë harroi trupin e vet Zbuluet
E në mëngjes e gjeti pikturë të varun
Në murin e gjanë dhetë pashë:
E kqyri dhe e kqyri e u zhduk.
Petkat e saj teren buzë detit
Me këmishën e gjarpnit mbi gurë.
Shtëpia tha se vjen prap,ajo, po Deri mbasdite.
Mbasdite vonë, gjarpni i rrejtun
Doli prej nëngurit E iu zgërdhesh vetmisë ndërsy,
Veshi këmishën e vjetër e shkoi me fjetë

MOTIV I VJETËR NË KTHIM

Shtatë vasha u çuen peshë
Kur ngjyra e korbit fluturoi Përmbi shtyllën e jetës:
Sqepi i dukej i verdhë, gati i bardhë
Mes pendlave të zeza.
Shtatë vasha u quen peshë
E u turrën vrap me funda
Në duer sa qethi mbas korbave
E vetëm me za i tretën si plafa të murmë
Nën karmat e vendit tim.
Po s'erdhët ju, vasha,
Kur të zbardhen pusat e ujit
Në lumë përpara agimit,
Ngurzohen edhe duert e foshnjeve
Në palare..

Martin Camaj,
Nderi i Kombit

PA HUMBUR KOHË

Le t'i mbledhim bashkë
Të gjitha legjendat nëpër shekuj ...
Le t'i hyjmë historisë
Të gjitha kronikat t'i shpalosim Bashkë
Ta gjejmë të vërtetën udhë
Drejt fronit të dashurisë!...
N'udhën time
Mund të ketë ndoj vonesë
Por mungesa kurrësi
Sot as nesër Askurrë
N'udhën time shekullore
Gjithçka në lëvizje
Me koordinim dashurie
Edhe këngët Edhe vallet rrjedhin
Pandalur Sikur sot
Deri në amshim Përjetemot ...
Ernest Koliqi

PËRGJITHMONË

O ajër i mbrëmjes mbështillmë,
erdhi ora të vdes përsëri.
Kur të mbyllen sytë e mi,
nuk do të ketë më det
Dhe varkat e lotëve kanë për të ngecur në stere.
Shkoj dhe shirat po i lë të kyçura
Por do të kthehem përsëri në çdo stinë që të dua.
Unë kam qenë trishtimi i botës.

O ajër i mbrëmjes mbështillmë,
erdhi ora të vdes përsëri.,.,

KËNGË LAHUTE


Më zuri gjumi i baladave
Dalin eterit pleq në prag të rapsodive
Dhe natë e ditë një zog më rri te kryet.
O ti zogu i zi i amanetit,
Për ku vrapon të bësh shi, o zog?
Dy tre shira ranë e u bë dimër,
Dy tre net u deshëm dhe u harruam.
Do të ngrihem e do të marr dynjanë
Por gjumi i baladave nuk më lë.
Dy tre shira ranë e u bë dimër,
Dy tre net u deshëm dhe u grindëm....

Frederik Reshpja
Përgatit nga Roza Pjetri

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri,
Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

ekspozita e librit *** ekspozita e librit ***ekspozita e librit ***



Mundësoi Botimin:
GJERGJ LEQEJZA

Ma.dj.sh Kimay
Produzione Giacche
PRODUCTION